



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM
FIER

RAPORTI VJETOR 2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

FIER

RAPORTI VJETOR

I TREGUESVE KRYESORË TË PUNËS PËR VITIN 2024,
TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
FIER

HYRJË

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në zbatim të nenit 50, pika 2, të ligjit nr. 97/2016, *“Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, nëpërmjet këtij materiali paraqet arritjet dhe objektivat e realizuara gjatë ushtrimit të ndjekjes penale në fazën e hetimit paraprak dhe në gjykim, kryerjen e detyrimeve të tjera të parashikuara në ligj nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, si dhe analizon treguesit sasiorë dhe cilësorë në përgjithësi dhe në veçanti për secilin prej tyre për vitin 2024.

Në fokusin e punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier gjatë këtij viti ka qenë trajtimi me përparësi i veprave penale, hetimi i të cilave është përcaktuar si prioritarë në rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, rekomandimet prioritarë të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024, udhëzimin e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 05/2024, *“Për rekomandimet prioritarë të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”*, udhëzimin e përgjithshëm të drejtuesit të Prokurorisë Fier nr. 46, datë 07.06.2024, *“Për rekomandimet prioritarë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”*, si dhe veprat penale problematike dhe më të përhapura që shqetësojnë komunitetin e Qarkut Fier, sikurse janë veprat penale kundër jetës e shëndetit, veprat penale kundër pasurisë, veprat penale kundër dhunës në familje dhe të miturve, veprat penale kundër trafikëve të paligjshme dhe narkotikëve, veprat penale kundër mjedisit, veprat penale kundër lojrave të fatit, etj.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier gjatë vitit 2024 ka qenë e organizuar me tre seksione, si më poshtë:

- Seksioni i posaçëm kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimin e terrorizmit dhe hetimet pasurore, i cili ka në fokus hetimin financiar dhe pasuror, veprat penale të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, pastrimin e parave, etj;
- Seksioni për drejtësinë penale për të mitur, për ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë.
- Seksioni i përgjithshëm për veprat e tjera penale.

Për një ndarje të drejtë të ngarkesës mes seksioneve, mbulimin e mungesave të prokurorëve që kanë ardhur kryesisht si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar, priorizimin e çështjeve me rëndësi, etj, nga ana e drejtuesit janë kërkuar informacione të vazhdueshme lidhur më ngarkesën dhe afatet hetimore, janë organizuar mbledhje periodike, si me drejtuesit e seksioneve ashtu edhe me prokurorët e çdo seksioni, me qëllim evidentimin e problematikave dhe gjetjen e zgjidhjeve. Gjithashtu, janë bërë riorganizime të seksioneve përmes lëvizjes së prokurorëve, përjashtimin nga shorti të prokurorëve me ngarkesë me të lartë për periudha të caktuara kohore, etj, me qëllim balancimin e ngarkesës dhe zbatimin e rekomandimeve për veprat penale prioritarë.

Theksojmë se, për vitin 2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka patur të miratuar në strukturë organike 64 (gjashtëdhjet e katër) punonjës, të ndarë si vijon: 1 (një) drejtues prokurorie, 1 (një)

zëvendës drejtues prokurorie, 22 (njëzet e dy) prokurorë, 18 (tetëmbëdhjetë) oficerë të policisë gjyqësore, 1 (një) kancelar, 1 (një) kryesekretare, 1 (një) përgjegjës sektorit të financës, 1 (një) specialiste IT-së, 11 (njëmbëdhjetë) sekretare pranë prokurorëve, 1 (një) koordinatorë, 1 (një) ftues, 2 (dy) shoferë, 1 (një) pastrues dhe 1 (një) punonjës shërbimi.

Në fakt, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier edhe gjatë vitit 2024 ka vazhduar të funksionojë me organikë jo plotë, kryesisht për shkak të mungesës së prokurorëve, ardhur si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar "vetting" dhe dinamikave që ka sjellë reforma në drejtësi, etj.

Më konkretisht, - nga muaji Janar deri në datën 22 Prill kanë ushtruar funksionin 13 (trembëdhjetë) prokurorë; - nga 22 Prilli deri në 23 Maj kanë ushtruar funksionin 12 (dymbëdhjetë) prokurorë; - nga 22 Maji deri në 10 Qershor kanë ushtruar detyrën 11 (njëmbëdhjetë) prokurorë; - nga data 10 Qershori deri në fund të muajit Korrik kanë ushtruar funksionin 12 (dymbëdhjetë) prokurorë; - nga fundi i muajit Korrik, me emërimin e dy magistratëve të rinj, dhe deri në fund të vitit 2024 kanë ushtruar funksionin 14 (katërmëdhjetë) prokurorë, duke përfshirë edhe drejtuesin. Pra, asnjëherë gjatë vitit nuk ka qenë e plotësuar organika. Për një pjesë të vitit kanë munguar 13 (trembëdhjetë) prokurorë, për një pjesë tjetër kanë munguar 12 (dymbëdhjetë) prokurorë, për një pjesë tjetër kanë munguar 11 (njëmbëdhjetë) prokurorë dhe për një pjesë tjetër të vitit kanë munguar 10 (dhjetë) prokurorë.

Në lidhje me oficerët e policisë gjyqësore, kanë ushtruar efektivisht detyrën 14 (katërmëdhjetë).

Pavarësisht mungesës së prokurorëve, kancelarit dhe oficerëve të policisë gjyqësore, Prokuroria Fier me angazhimin dhe përgjegjshmërinë e prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe nënpunësve të tjerë të administratës, në bashkëpunim edhe me policinë gjyqësore të shërbimeve dhe organeve të tjera ligjzbatuese, si dhe institucioneve të tjera, ka përballuar me sukses ngarkesën e lartë të punës duke arritur edhe disa tregues pozitivë në drejtimit dhe përparësitë e luftës kundër kriminalitetit për vitin 2024.

Përsa i përket ngarkesës së Prokurorisë Fier, gjatë vitit 2024 kanë qenë në ndjekje dhe janë trajtuar:

- 4528 (katërmijë e pesëqind e njëzet e tetë) procedime penale, me 1567 (njëmijë e pesëqind e gjashtëdhjet e shtatë) persona në hetim/të pandehur, nga të cilët 568 (pesëqind e gjashtëdhjet e tetë) persona nën hetim dhe 1008 (njëmijë e tetë) të pandehur. Nga numri total i 4528 (katërmijë e pesëqind e njëzet e tetë) procedimeve penale në ndjekje, 2086 (dymijë e tetëdhjet e gjashtë) procedime penale¹ janë regjistruar në vitin 2024, 2428 (dymijë e katërqind e njëzet e tetë) procedime penale janë mbartur nga vitet e kaluar dhe 14 (katërmëdhjetë) procedime penale janë rifilluar. Në lidhje me këto procedime penale, janë përfunduar 2363 (dymijë e treqind e gjashtëdhjet e tre) procedime

¹ Në këtë numër total prej 2086 procedime penale të regjistruara në vitin 2024, përfshihen 2005 procedime penale të regjistruara rishtazi në vitin 2024, 37 procedime penale të ardhura për kompetencë nga prokuroritë e tjera, 14 procedime penale të rifilluara dhe 44 procedime penale të bashkuara. Vlen të sqarohet se në statistikën vjetore të vitit 2024 janë raportur si procedime të reja 2056 procedime penale, nga të cilat 2005 procedime penale të regjistruara të reja, 37 procedime penale të ardhura për kompetencë dhe 14 procedime penale të rifilluara, kurse 44 procedime penale të bashkuara nuk janë raportuar në statistikën vjetore 2024 pasi nuk ka patur rubrikë më vehte, pavarësisht se edhe këto procedime penale janë trajtuar dhe hetuar te deri në momentin e bashkimit të tyre.

penale, të cilat përbëjnë 52 % të çështjeve penale që kanë qenë në ndjekje gjatë vitit, si dhe më shumë se numri total i procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2024;

- 164 (njëqind e gjashtëdhjet e katër) referime pasurore, nga të cilat 7 (shtatë) referime pasurore të regjistruara në vitin 2024 dhe 157 (njëqind e pesëdhjet e shtatë) referime pasurore të mbartuara nga vitet e kaluara. Nga këto referime pasurore, janë regjistruar 5 (pesë) procedime pasurore;

- 364 (treqind e gjashtëdhjet e katër) kallëzime penale të mosfilluara;

- 1069 (njëmijë e gjashtëdhjet e nëntë) njoftime nga viktimat akuzuese dhe referime që dukshëm nuk përbëjnë vepër penale, nga të cilat janë arkivuar 786 (shtatëqind e tetëdhjet e gjashtë) raportime, janë mbarur 184 (njëqind e tetëdhjet e katër) raportime për vitin 2025 dhe janë regjistruar si kallëzime penale 99 (nëntëdhjet e nëntë) raportime, prej të cilave janë mosfilluar 36 (tridhjet e gjashtë) kallëzime penale, regjistruar 60 (gjashtëdhjet) procedime penale dhe mbarur 3 (tre) kallëzime penale.

- 62 (gjashtëdhjet e dy) kërkesa lidhur me marrdhëniet juridiksionale me jashtë, nga të cilat 45 (dyzet e pesë) kërkesa për ndihmë juridike, 15 (pesëmbëdhjetë) kërkesa për ekstradim dhe 2 (dy) kërkesa për njohje vendimi penal të huaj;

- 1289 (njëmijë e dyqind e tetëdhjet e nëntë) praktika për të cilat janë nxjerrë urdhëra ekzekutimi;

- 34 (tridhjet e katër) praktika për kërkim ndërkombëtar;

- 413 (katërqind e trembëdhjetë) kërkesa në fazën e ekzekutimeve të vendimeve penale, nga të cilat 14 (katërmëdhjetë) për kompesim për burgim të padrejtë, 17 (shtatëmbëdhjetë) për bashkim dënimesh, 68 (gjashtëdhjet e tetë) për lirim para kohe me kusht, 7 (shatë) për dëmtime të tjera me dashje, 6 (gjashtë) për fyerje/shpifje, 63 (gjashtëdhjet e tre) për përfitim nga amnistia, 20 (njëzet) për ulje dënimi, 5 (pesë) për dëmshpërblim page, 16 (gjashtëmbëdhjetë) për heqje zotësie për të vepruar, 26 (njëzet e gjashtë) për masa mjekësore, 5 (pesë) për rivendosje në afat, 38 (tridhjet e tetë) për shuarje dënimi pasuror dhe 128 (njëqind e njëzet e tetë) kërkesa me objekte të tjera në fazën e ekzekutimit.

Në mënyrë të përmbledhur në këtë raport do të paraqesim më poshtë treguesit e veprimtarisë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier gjatë vitit 2024, në ushtrimin e ndjekjes penale, në hetimin paraprak dhe në gjykim, si dhe funksionet e tjera të përcaktuara me ligj për prokurorinë.

Informacioni përmban të dhëna mbi çështjet e referuara, procedimet penale të regjistruara dhe ato të përfunduara, çështjet e mosfilluara, zgjidhja ligjore e tyre, çështjet e mbartura nga vitet e kaluara, ecurinë e çështjeve në gjykim, të dhëna mbi ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe të dhëna të tjera.

I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT.

1. Në themel të veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka qenë lufta kundër veprave penale në fushën e pastrimit të parave apo grupveprat që lidhen me gjurmimin e pasurimit të paligjshëm, duke patur në fokus goditjen e këtij fenomeni nëpërmjet masave përkatëse të parashikuara nga ligji procedural penal apo edhe ligjet e posaçme, si ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*, i ndryshuar (këtu e më poshtë ligji *“Antimafia”*).

Në funksion të kësaj lufte, gjatë vitit 2024 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka patur në hetim 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, nga të cilat janë dërguar në gjykim 2 (dy) çështje, janë pushuar 5 (pesë) çështje, janë pezulluar 4 (katër) çështje dhe janë transferuar 4 (katër) çështje. Për nenin 287 të Kodit Penal, gjatë vitit 2024 janë regjistruar 15 (pesëmbëdhjetë) çështje penale të reja dhe 1 (një) çështje penale është rifilluar. Nga vitet e mëparshme janë mbartur 144 (njëqind e dyzetë e katër) çështje penale. Në raport krahasues me vitin 2023, gjatë të cilit kanë qenë në hetim 151 (njëqind e pesëdhjetë e një) çështje penale, rezulton se në vitin 2024 kanë qenë në hetim 9 (nëntë) çështje penale më shumë.

Gjatë vitit 2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier përfundoi hetimet dhe dërgoi në gjyq 2 (dy) procedime penale për veprën penale *“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”*, parashikuar në nenin 287 të Kodit Penal, një çështje më tepër në gjykim në krahasim me vitin 2023.

Gjithashtu, në vitin 2024 janë kryer sekuestre dhe konfiskime të konsiderueshme pasurish, bazuar në ligjin nr.10192/2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*, i ndryshuar, me vlerë disa milion euro. Konkretisht, janë kërkuar dhe dhënë nga gjykata 5 (pesë) vendime për sekuestrim të pasurive, 3 (tre) vendime për konfiskim pasurie sipas ligjit *“antimafia”*, si dhe 2 (dy) vendime për vendosjen e sekuestros preventive sipas nenit 275 të Kodit të Procedurës Penale.

Për veprat penale të parashikuara nga nenet 287 dhe 287/b të Kodit Penal, gjatë vitit 2024: Është dërguar për gjykim 1 (një) çështje penale, janë pushuar 4 (katër) çështje penale, janë kthyer aktet për 1 (një) çështje penale dhe janë dhënë 2 (dy) vendime dënimi për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kenal Penal. Ndësa për nenin 287/b të Kodit Penal, janë dhënë një vendim pafajësie dhe një vendim dënimi.

Pavarësisht prioritizimit të këtyre veprave penale gjatë vitit 2024, rezultatet nuk kanë qenë në nivelin e dëshiruar, ndër të tjera për shkak të ngarkesës së lartë, kryesisht mbartur nga vitet e mëprashme, mungesës së organikës së plotë me afërsisht 40 %, si dhe hetimi dhe përfundimi i një numri të lartë çështjesh për vepra të tjera penale apo çështje me shkallë vështirësie të konsiderueshme, qoftë në drejtimet prioritare (hetime pasurore ku rezultatet kanë qenë në rritje) apo që kërkonin ndjekje në dinamikë dhe të shpejtë.

Gjithashtu, në vitin 2024 rezulton se, përfundimisht janë nxjerrë urdhra ekzekutimi lidhur me konfiskimet e pasurive sipas ligjit "antimafia" dhe konkretisht, për vendimin nr. 231 datë 24.11.2022, të ish-Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë që ka marrë formë të prerë me vendimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të datës 15.10.2024, për shtetasin F.A, si dhe për vendimin nr. 238, datë 12.10.2020, të ish-Gjykatës së Apelit Vlorë, për pasuritë e shtetasit L.L.

Me vendimin nr. 231 datë 24.11.2022, të ish-Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, që ka marrë formë të prerë në datën 15.10.2024, janë konfiskuar pasuritë më poshtë:

- pasuria nr. 22/314-N13, z.k.8571, Lushnje, me sipërfaqe 27.03 m², e llojit "njësi shërbimi";
- pasuria Nr.22/314-N14, z.k.8571, Lushnje, me sipërfaqe 184.11 m², e llojit "njësi shërbimi";
- pasuria Nr.22/314-N15, z.k.8571, Lushnje, me sipërfaqe 54.9 m², e llojit "njësi shërbimi";
- pasuria Nr.22/314-G, z.k.8571, Lushnje, me sipërfaqe 107.95 m², e llojit "garazh";
- pasuria Nr.18/199+2-89, z.k.8571, Lushnjë, me sipërfaqe 130.58 m², e llojit "apartament";
- lokal shërbimi me sipërfaqe 64,8 m², në lagjen "Gafurr Muço", Lushnjë;
- apartament me sipërfaqe 78.49 m², në lagjen "Gafurr Muço", Lushnjë".

Në lidhje me hetimet financiare vlen të evidentohet se, në 5 (pesë) procedime pasurore, prej të cilëve 4 (katër) të regjistruara kryesisht, dhe në 1 (një) procedim penal, janë sekuestruar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme me vlera të larta, të cilat në 2 (dy) raste kanë përfunduar veprimet dhe janë dërguar më pas në gjykatë me kërkesë për konfiskim, si më poshtë:

➤ Në një procedim pasuror të regjistruar kryesisht, është sekuestruar pasuri e paluajtshme në emër të shtetasit N. Gj., zotëruar në mënyrë tërthortë prej shtetasi A. Gj., si më poshtë:

- pasuri e llojit "Ndërtesë Bar-Restorant-Hotel me 3 kate + papafingo" me sipërfaqe 363 m²; zona kadastrale 1492, Divjakë.

➤ Në një procedim pasuror janë sekuestruar pasuri të paluajtshme në zotërim të shtetasit E.B., si më poshtë:

- pasuri e llojit "apartament", me sipërfaqe 138.3 m²;
- pasuri e llojit "apartament", me sipërfaqe 50 m².

➤ Në një procedim pasuror të regjistruar kryesisht janë sekuestruar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme me vlerën mbi 1.8 (një pikë tetë) milion Euro, në zotërim të shtetasit A.M., si më poshtë:

- pasuria e llojit "Arë", me sipërfaqe 2281 m²;
- pasuria e llojit "Arë", me sipërfaqe 4550 m²;
- pasuria e llojit "Njësi", me sipërfaqe 200 m²;

- pasuria e llojit "Truall", me sipërfaqe prej 210 m²;
- pasuria e llojit "Truall", me sipërfaqe prej 210 m²;
- pasuria e llojit "Truall", me sipërfaqe prej 210 m²;
- pasuria e llojit "Njësi" 2-kate;
- pasuria e llojit "Njësi" me sipërfaqe 100 m²;
- pasuria e llojit "Apartament" nr. 41 (3+1), me sipërfaqe totale 127.4 m²;
- pasuria e llojit "Vendparkimin nr.29" në katin -1, prej 30.14 m²;
- automjeti i markës të markës "Lamborghini", modeli "Urus", vit prodhimi 2018;
- automjeti i markës "Mercedes-Benz", modeli "G- 63 AMG", vit prodhimi 2020;
- automjeti i markës "Volksäagen", model "Touran" vit prodhimi 2013;
- automjeti i markës "BMË", modeli "X5" 3.0d, vit prodhim 2007;
- automjet i markës "Audi", model "S-8", vit prodhimi 2021;
- automjeti i markës "Audi", model "RS-Q8", vit prodhimi 2021;
- automjeti i markës "Mitsubishi", model "L200", vit prodhimi 2014;
- automjeti i markës "Mercedes Benz", modeli "C220CDI", vit prodhim 2001;
- automjeti i markës "BMË", modeli "X5", vit prodhim 2014;
- automjeti i markës "KIA", modeli "Carnival", vit prodhim 2000;
- automjeti i markës "Audi", model "Q7", vit prodhimi 2016;
- automjeti i markës "KIA", modeli "Carnival", vit prodhim 2000;
- autobus i markës "Neoplan", model "N515/3SHDHC", vit prodhimi 2003;
- llogari bankare në vlerën rreth 120.000 Euro;
- sende të çmuara me vlera të konsiderueshme;

Ky procedim pasuror është përfunduar dhe është kërkuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier konfiskimi e pasurive të mësipërme.

Po ashtu, në funksion të procedimit penal nr. 1162, të vitit 2020, regjistruar për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, mbi bazën e kërkesës së organit të akuzës dhe vendimit të Gjykatës të datës 11.06.2024, është lejuar kontrolli i banesës dhe i ambienteve të tjerë në përdorim të shtetasit A.M dhe gjatë kontrollit janë gjetur dhe sekuestruar:

- Një automjet "Ferrari", model "California", me vlerë rreth 130.000 Euro;
- Ora të markës "Rolex", si dhe bizhuteri dhe sende të tjera të çmuara me vlera të konsiderueshme.

➤ Në një procedim pasuror të regjistruar kryesisht janë sekuestruar pasuri, në zotërim të tërthortë të shtetasit S.T., si më poshtë:

- Pasuria nr. 1/527, , e llojit "truall, ZK 8572, vol. 25, fq. 96, ndodhur në lagjen "Loni Dhamo", Lushnjë";
- Pasuria nr. 104/44, e llojit "arë", ZK 3268, vol 2, fq. 182, ndodhur në Savër, Lushnjë, me sipërfaqe 15,323 m²;
- Pasuria nr. 857/28, e llojit "arë", ZK 2087, vol. 8, fq. 193, ndodhur në Karbunarë e Poshtme, Lushnjë;
- Pasuria nr. 151/2+1-10, e llojit "apartament", me sipërfaqe 128 m², ZK 3266, ndodhur në Sauk, Tiranë;

- Pasuria nr. 102/22-16, e llojit "apartament", me sipërfaqe 96.17 m², ZK 3266, ndodhur në Sauk, Tiranë;
- Pasuria nr. 104/81+2-21, e llojit "apartament", me sipërfaqe 105.57 m², ZK 3266, ndodhur në Sauk, Tiranë;
- Pasuria nr.4/1, ZK. 8572, lloji "truall", me përshkrimin "Godinë ekonomike 2 kate, karburant dhe ambiente shërbimi", ndodhur në lagjen "18 Tetori", Lushnjë;
- Pasuria nr.4/2, ZK. 8572, vol. 24, fq. 197, e llojit "truall", e ndodhur në lagjen "18 Tetori", Lushnjë. Objekti i ndërtuar plotësisht në të me vlerë 9.724.582 Lekë;
- Pasuria nr. 3/1, ZK. 8572, me sipërfaqe totale ndërtimi 306 m² me përshkrimin "Godinë ekonomike 1 kt + bodrum", ndodhur në Plug, Lushnjë;
- Pasuria nr. 1/450, ZK. 8572 e llojit "truall", me përshkrim të veçantë, shtuar "njësi shërbimi 3 kate + rikonstruksion karburanti ekzistues + pikë gazi", e ndodhur në lagjen "Loni Dharmo", Lushnjë.

Ky procedim pasuror është përfunduar dhe në datën 09.09.2024 është kërkuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier konfiskimi e pasurive të mësipërme.

➤ Në një procedim pasuror të regjistruar kryesisht janë sekuestruar pasuri që kapin vlerën mbi 1 (një) milion Euro, në zotërim të shtetasit N.GJ. dhe personave të lidhur me të, si më poshtë

- njësi tregtare (dyqan) me sipërfaqe 100 m², porositur nga Vilajet Gjolenë, ndodhur në objektin "Godinë banimi e shërbimi 2-7-10 kate me garazh (nën tokë) -kati përdhe dyqane", ndodhur në lagjen nr.13, Sek.Apollonia, Plazh, Durrës, miratuar me lejen e ndërtimit nr. 03, datë 23-24-25.11.2011 të Këshillit të Rregullimit të Territorit pranë Bashkisë Durrës;
- pasuritë: nr. 9/366/ND+1-2, nr. 9/366/ND+1-3, nr. 9/366/ND+1-4, nr. 9/366/ND+1-11, nr. 9/366/ND+1-27, nr. 9/366/ND+1-41, nr. 9/366/ND+1-42, nr. 9/366/ND+1-62, nr. 9/366/ND-N2 dhe nr. 9/366-ND-N4, zk 8518, Plazh/13, Durrës;
- tre apartamente: nr. 27, me sipërfaqe 75.7 m², i ndodhur në kuotën +13.47; nr.46 (2+1) me sipërfaqe 103.2 m²; nr.44 (1+1) me sipërfaqe 80.6 m²; dy garazhe (garazhi me nr. 12 i ndodhur në kuotën -2.80, me sipërfaqe 40,3 m²; garazhi me nr. 13 i ndodhur në kuotën -2.80, me sipërfaqe 40,3 m²); të ndodhura në objektin "Strukturë banimi dhe shërbime 5, 7 dhe 9 kate, me 2 kate parkim nëntokë" sipas lejes zhvillimore nr. 11303/1, datë 14.10.2014, të Bashkisë Tiranë, me zhvillues shoqërinë "LK & CTD" shpk, të ndodhur tek rruga "Shinasi Dishnica" (ose Rruga e "Saraçëve"), Tiranë;
- pasuria nr.5/449+2-15, e llojit "apartament", zk 8130, Tiranë;
- pasuria nr.6/319/ND, e llojit ndërtesë, me sipërfaqe 115.8 m², zk 8140, Tiranë;
- pasuria nr.3/138+1-2, e llojit "apartament", me sipërfaqe 83,1m², zona kadastrale 8140, vol.15, fq.99, rruga "Qemal Stafa", Tiranë, pll.490, shk.1, k.1, ap.2;
- autoveturë me targa "AA692IL", e markës Peugeot;
- kuotat e shoqërisë "Erini-2013" sh.p.k. me NIPT L32103007A.

➤ Në procedimin pasuror nr. 2, të vitit 2023, janë përfunduar verifikimet dhe është dërguar në Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier kërkesa për konfiskim të pasurive të luajtshme e të paluajtshme, me vlerë rreth 2.5 (dy pikë pesë)

milion Euro, të zotërim direkt apo indirekt të shtetasve Julian Hoxha dhe Gentjan Hoxha, si më poshtë:

- pasuria nr.1/555+1-17, volum 46, faqe 88, Z.K. 8532, me sipërfaqe 399.6m² (Verand)+ pasuria nr.1/555+1-18, volum 46, faqe 89 Z.K. 8532, me sipërfaqe 56.9m², në total 456.5m², nga të cilat sipërfaqe banimi 121.9m² papafingo (bashkëpronësi) shtesë kati;
- pasuria nr.1/555+1-11, volum 43, faqe 156, Z.K. 8532, me sipërfaqe 73.9m², lloji "Ap.1+1", me adresë në Fier, lagjia "Bishanak";
- pasuria nr.1/555+1-16, volum 43, faqe 161, Z.K. 8532, me sipërfaqe 102m², lloji "Ap.2+1", me adresë në Fier, lagjia "Bishanak";
- pasuria nr.1/555+1-15, volum 43, faqe 160, Z.K. 8532, sipërfaqe 73.9m², lloji "Ap.1+1", me adresë në Fier, lagjia "Bishanak";
- pasuria nr.1/555+1-12, volum 43, faqe 157, Z.K. 8532, me sipërfaqe 102 m², lloji "Ap.2+1", me adresë në Fier, lagjia "Bishanak";
- pasuria nr.1/555+1-9, volum 43, faqe 154, Z.K. 8532, me sipërfaqe 100.4 m², lloji "Ap. 2+1", me adresë në Fier, lagjia "Bishanak";
- pasuria nr.1/555-N2, volum 43, faqe 145, Z.K. 8532, me sipërfaqe 375.4 m², lloji "Njësi", me adresë në lagjen "Bishanak", Fier;
- pasuria nr.1/555+1-1, volum 43, faqe 146, Z.K. 8532, me sipërfaqe 103.8 m², lloji "Aparament", me adresë në lagjen "Bishanak", Fier;
- pasuria nr.198/18, volum 8, faqe 76, Z.K. 1033, me sipërfaqe 1200m², lloji "Magazinë", me adresë Kolonjë, Lushnjë;
- pasuria nr.205/40, volum 8, faqe 157, Z.K. 1033, me sipërfaqe 1920 m², me adresë në Lushnjë;
- pasuria nr.199/59, volum 7, faqe 163, Z.K. 1033, me sipërfaqe 1257 m², lloji "Arë", me adresë në Lushnjë;
- pasuria nr.198/22, volum 8, faqe 201, Z.K. 1033, me sipërfaqe 1500 m², me adresë në Lushnjë;
- pasuria nr.198/23, volum 9, faqe 31, me sip.607 m², Z.K. 1033, lloji "tokë arë", me adresë në Lushnjë;
- pasuria nr.198/24, volum 9, faqe 32, me sipërfaqe 893 m², Z.K.1033, lloji "tokë arë", me adresë në Lushnjë;
- pasuria nr.199/89, volum 9, faqe 33, me sipërfaqe 935 m², Z.K.1033, lloji "tokë arë", me adresë në Lushnjë;
- pasuria nr. 199/90, volum 9, faqe 33, me sipërfaqe 1063 m², Z.K. 1033 lloji "tokë arë", me adresë në Lushnjë;
- pasuria nr.1/555-B1, volum 43, faqe 143, Z.K. 8532, me sipërfaqe 308.8 m², lloji "bodrum", me adresë në Fier;
- pasuria nr.199/88, volum 8, faqe 202, me sipërfaqe 1998m², Z.K. 1033, me adresë në Lushnjë;
- pasuria nr.205/42, volum 9, faqe 9, Z.K. 1033, me sip. 3300 m², lloji "ullishte", me adresë në Lushnjë;
- pasuria nr.198/22, volum 8, faqe 201, Z.K. 1033, me sipërfaqe 1500m², me adresë në Lushnjë;
- pasuria nr.1/555+1-18, volum 46, faqe 89, Z.K. 8532, me sipërfaqe 56.9m², me

adresë në Lushnjë;

- *pasuria nr.1/555+1-3, volum 43, faqe 148, Z.K. 8532, Fier, me sipërfaqe 78.7m²;*
- *Pasuria nr.1/555+1-13, volum 43, faqe 158, Z.K. 8532, Fier, me sipërfaqe 100.4 m², lloji "Ap.2+1";*
- *automjeti me targat AA 630 IL, i markës "Mercedes Benz", tip "ml 6.3 AMG", vit i prodhimit 2009;*
- *automjeti tip "Hyndai Avante", vit i prodhimit 2015;*
- *automjeti i markës "Hyndai Tucson", vit prodhimi 2021;*
- *shuma monetare 25,906.40 Euro dhe 320.13 Euro pranë "Fi Bank";*
- *shuma monetare 1,703 Euro pranë Credins Bank;*
- *kuotat, aksionet, asetet dhe pasurisë e subjektit "Evergreen Fitnes", me Nipt L83214402D;*
- *pasuritë e personit fizik "Julian Hoxha", me NIPT M17222131V.*
- *pasuritë e personit fizik "Xhemil Hoxha", me NIPT L43114401L;*
- *pasuritë e personit fizik "Aida Hoxha", me Nipt M13413401N, si dhe pajijes e qendrës estetike.*

1.1. Në lidhje me veprat penale kundër narkotikëve, për vitin 2024 janë regjistruar 117 (njëqind e shtatëmbëdhjetë) procedime penale.

Gjithashtu, janë regjistruar 6 (gjashtë) procedime penale për veprat penale të korrupsionit dhe ushtrimit të ndikimit të paligjshëm, të parashikuara nga nenet 244, 245/1 dhe 259, prg.1, të Kodit Penal, si dhe janë dërguar për gjykim 4 (katër) procedime me 7 (shtatë) të pandehur.

Pavarësisht fokusit në këto grupvepra, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier janë hetuar në mënyrë efikase dhe dërguar për gjykim edhe veprat e tjera penale, të cilat do të paraqiten në vijim në aspektin sasior dhe cilësor.

2. Në aspektin e rolit aktiv të prokurorit në drejtim të regjistrimit kryesisht të procedimeve penale, konstatohet se, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier janë regjistruar 61 (gjashtëdhjetë e një) kallëzime kryesisht, nga të cilat 5 (pesë) të regjistruara kryesisht dhe 56 (pesëdhjetë e gjashtë) janë ndarë nga procedime të tjera për vepra penale ose të dyshuar, të identifikuar gjatë hetimit, për të cilat ishte e nevojshme vazhdimi i hetimeve. Tetë nga këto kallëzime penale janë regjistruar mbi bazën e informacionit të siguruar nga mediat ose burime të tjera.

Në vitin 2024 janë regjistruar 7 (shtatë) referime pasurore, (3) tre prej të cilave janë filluar kryesisht nga prokurorët dhe 4 (katër) janë referime nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier. Nga këto referime pasurore, janë regjistruar 3 (tre) procedime pasurore. Gjithashtu, gjatë vitit 2024 janë regjistruar 2 (dy) procedime pasurore mbi bazën e referimeve pasurore të viteve paraardhëse. Nga viti 2023 janë mbartur 157 referime pasurore. Për vitin 2024 janë marrë 4 vendime për mosfillimin e procedimeve pasurore.

Pavarësisht kësaj, në takimet e punës dhe mbledhjet e zhvilluara në mënyrë të vazhdueshme me trupën e prokurorëve dhe oficerët të policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë lidhur me mbarëvajtjen dhe problematikat në punë, i është kushtuar rëndësi kësaj forme të inicimit të procedimeve penale, e cila lidhet drejtpërdrejtë me rritjen e rolit

aktiv të prokurorit dhe ndërgjegjësimin për mjetet procedurale që ligji i njeh. Nga ana tjetër, konstatohet se, në drejtim të hetimeve proaktive, kjo formë e hetimit është përdorur në hetimin e veprave penale kundër narkotikëve, shëndetit, pasurisë, si dhe për veprat penale që lidhen me shpërdorimin e detyrës nga funksionarët publikë.

Në funksion të rritjes së rolit aktiv të prokurorit në drejtim të regjistrimit kryesisht të procedimeve penale, drejtuesi i prokurorisë ka nxjerrë edhe disa urdhra dhe udhëzime të përgjithshme, sikurse janë:

- Udhëzim i Përgjithshëm nr.46, datë 07.06.2024, *“Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”*.

- Urdhër nr.52, datë 14.06.2024, *“Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”*.

Gjatë vitit 2024, ka qenë në fuqi urdhri nr. 59, datë 19.12.2023, i drejtuesit të prokurorisë *“Për masat administrative/procedurale për rritjen e hetimeve të filluara kryesisht përmes informacioneve mediatike, internetit dhe burimeve të tjera të hapura, etj”*, sipas të cilit janë ngarkuar dy oficerë të policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë për të monitoruar publikimet që vijnë nga media dhe burimet e tjera të hapura, kurse me mbikëqyrjen e zbatimit të urdhrit janë ngarkuar drejtuesit e seksioneve dhe prokurori i medias e marrëdhënieve me publikun.

Në vitin 2024 janë regjistruar dy kallëzime ndaj dy gazetarëve të emisionit investigativ “Stop” të TV Klan, për njërin prej të cilëve është vendosur mosfillimi i procedimit penal, ndërsa kallëzimi tjetër është në proces verifikimi.

Duke patur në konsideratë ngarkesën mjaft të lartë të prokurorëve për asrye objektive të shprehura më lart, vlerësohet se numri i kallëzimeve/procedimeve penale të regjistruara kryesisht ka qenë relevant me mundësitë dhe rrethanat.

3. Me qëllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Udhëzimet e Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe planit të veprimit për luftën kundër kriminalitetit, lidhur me rekomandimet e rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave për prioritet e luftës kundër kriminalitetit, si dhe me synimin për të ndihmuar në përmirësimin e punës, janë nxjerrë 105 (njëqind e pesë) urdhra dhe 1 (një) udhëzim i përgjithshëm nga drejtuesi i prokurorisë, që sigurojnë zbatimin e rekomandimeve prioritare dhe garantojnë e lehtësojnë zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe jo vetëm.

Konkretisht:

Në bazë të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 10, datë 07.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm *“Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimet pasurore në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”*, është nxjerrë urdhri i drejtuesit të prokurorisë nr.7, datë 10.01.2024, *“Për riorganizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”* dhe urdhri i drejtuesit të prokurorisë nr.55, datë 25.06.2024, *“Për disa ndryshime në urdhrin nr.7, datë 10.01.2024, “Për riorganizimin e seksioneve në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”*.

Në përbërjen e seksionit të posaçëm kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimin e terrorizmit dhe hetimet pasurore, janë caktuar fillimisht 3 (tre) prokurorë dhe 4 (katër) oficerë të policisë gjyqësore, kurse gjatë vitit ky seksion është bërë me 4 (katër) prokurorë.

Në përbërjen e seksionit për të mitur, ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, janë caktuar 3 (tre) prokurorë dhe 3 (tre) oficerë të policisë gjyqësore.

Në përbërjen e seksionit të përgjithshëm për veprat e tjera janë caktuar 6 (gjashtë) prokurorë dhe 6 (gjashtë) oficerë të policisë gjyqësore.

- Lidhur me rritjen e angazhimit institucional në drejtim të veprave penale të krimit kibernetik dhe mashtrimit në internet me fokus të miturit.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier nuk është caktuar një prokuror i posaçëm për trajtimin e veprave penale në fushën e krimit kibernetik, por këto vepra janë trajtuar nga prokurorët e seksionit përkatës. Gjithashtu, rezulton se prokurorët, sipas përzgjedhjeve që kanë kryer lidhur me trajnimet që ndjekin, kanë ndjekur ndër të tjera edhe trajnime në këtë fushë. Shtrohet e nevojshme që të kryhen trajnime të specializuara në këtë fushë dhe afatgjata nga ana e prokurorëve të seksionit ku janë përcaktuar këto vepra.

Gjatë vitit 2024 ka vijuar bashkëpunimi ndërinstitutional me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe me Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, në të cilat janë organizuar seksione të veçanta me oficerë të specializuar në fushën e krimit kibernetik. Nga ana e prokurorëve është ndjekur rregulli i delegimit të dosjeve në këto seksione të veçanta të cilat janë të specializuara në këtë fushë, por edhe janë pika lidhëse me rrjetin e pikave të kontaktit.

Shtrohet e domosdoshme që oficerët të kryejnë trajnime të specializuara në këtë fushë, por edhe takime me specialistë dhe oficerë të policisë gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit apo në Drejtorinë Vendore të Policisë.

- Në kuadrin e forcimit të kontrollit dhe llogaridhënies së oficerëve të policisë gjyqësore, në zbatim të ligjit nr. 25/2019, *“Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”*, si dhe udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 2, datë 29.12.2016, *“Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori”*, është nxjerrë urdhri i drejtuesit të prokurorisë nr.27, datë 12.03.2024, *“Për disa ndryshime në urdhrin nr.55, datë 23.06.2023, “Për ndarjen e Oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksionit të prokurorisë sipas prokurorëve”, i ndryshuar. Në funksion të përfundimit të çështjeve penale të pezulluara dhe të parashkruara, të mbartuara për shumë vite si shkak i ngarkesës, është caktuar gjatë një pjese të vitit një oficer i policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë i dedikuar, për përfundimin e tyre dhe reduktimin e numrit të këtyre çështjeve penale.*

- Po ashtu, në kuadër të organizimit dhe mbikëqyrjes së mbarëvajtjes së punës, nga drejtuesi i prokurorisë janë nxjerrë ndër të tjera edhe urdhrat e mëposhtëm:

- Urdhri nr. 03/2, datë 15.01.2024, *“Për përcaktimin e zonave të sigurisë në Prokurori”*.

- Urdhri nr.3/3, datë 15.01.2024 *“Për caktimin e strukturës së Sigurisë”*.

- Urdhri nr.3/4, datë 05.01.2024, *“Për caktimin e Oficerit të Sigurisë”*.

- Urdhri nr. 27/1, datë 20.05.2024, *“Për disa ndryshime në urdhrin nr.27, datë 11.09.2023, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të*

Juridiksionit të Përgjithshëm Fier “Për ngritjen e komisionit të ekspertizës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe organizimin e punës së arkivit”.

- Urdhri nr. 44, datë 31.05.2024, *“Për ngritjen e grupit të punës për nxjerrjen dhe plotësimin e pyetësorëve të kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme për veprën penale të pastrimit të parave sipas modeleve të dërguara nga “Sekretriati Moneyval”.*

- Urdhri nr. 58, datë 10.07.2024 *“Për disa ndryshime në urdhrin nr.55, datë 23.06.2023, “Për ndarjen e Oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksionit të prokurorisë sipas prokurorëve”.*

- Urdhri nr.86, datë 01.10.2024, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr.55, datë 23.06.2023 “Për ndarjen e Oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve të prokurorisë sipas prokurorëve” dhe marrjen e masave shtesë për mirëfunktionimin e Prokurorisë Fier”.*

- Urdhri nr.79, datë 20.09.2024, *“Për mënyrën e trajtimit dhe shpërndarjes të vendimeve gjyqësore civile “Urdhra mbrojtje”, të dërguara nga gjykata”.*

- Urdhri nr. 80, datë 23.09.2024, *“Për disiplinimin e hyrje-daljeve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, si dhe miratimin e procedurës së hartimit të listëprezencës në punë”.*

- Urdhri nr. 98, datë 08.11.2024, *“Për ngritjen e grupit të punës për transferimin e dosjeve në arkivën e godinës së ish-Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Kavajë”.*

- Urdhri nr.100, datë 14.11.2025, *“Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e procedurës administrative të ndjekur dhe përgjegjesisë disiplinore”.*

- Urdhri nr.107, datë 26.11.2024, *“Për riorganizimin e pjesshëm të zyrave në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”.*

- Urdhri nr.111, datë 12.12.2024, *“Për qarkullimin e materialeve të para hetimore, referimeve dhe kallëzimeve penale në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”.*

- Urdhri nr. 118, datë 18.12.2024, *“Për rregullimin e përkohshëm të procedurave të qarkullimit të dosjeve të përfunduara gjatë periudhës së delegimit të kompetencave të drejtuesit”.*

- Urdhri nr.119, datë 18.12.2024, *“Për caktimin/transferimin e prokurorit Redona Ndoni në Seksionin për të mitur, ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, duke filluar nga data 01.01.2025.*

Në lidhje me masat e marra për disiplinimin e procedurave dhe standardeve që garantojnë sigurimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, janë hartuar akte për të garantuar zbatimin e procedurave dhe standarteve të sigurimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, si dhe nisur procesi i akreditimit të sitemit “stand alone”.

• Në funksion të mbarëvajtjes së punës janë organizuar takime/mbledhje të përbashkëta mes prokurorëve dhe oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore, duke u bërë të njohur problematikat e evidentuara në kryerjen e veprimeve procedurale, si dhe janë udhëzuar oficerët e policisë gjyqësore në aspektin procedural, për kryerjen e plotë të veprimeve të para hetimore, mënyrën e përgatitjes së akteve, etj. Ndër të tjera janë organizuar mbledhjet/takimet si më poshtë:

- Mbledhje e zhvilluar në datën 07.06.2024, mes Drejtueses së Seksionit të Posaçëm dhe oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier të seksionit të krimit ekonomik dhe që hetojnë veprën penale të pastrimit të produkteve, lidhur me identifikimin e rasteve që janë në hetim, për të cilat mund të përfundojë hetimi dhe të paraqiten kërkesa në gjykatë, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve prioritare.
- Mbledhja e datës 09.05.2024, me objekt zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 03, datë 25.04.2024, *“Për përdorimin e platformës elektronike për raportimin e të dhënave për korrupsion dhe krim të organizuar”*, diskutimin mbi problematikat në bashkëpunimin me policinë gjyqësore, prioritetet e luftës kundër kriminalitetit për vitin 2024 në Prokurorinë Fier, etj.
- Mbledhja e datës 20.11.2024, me prokurorët e Seksionit të Posaçëm dhe me përfaqësues të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Drejtorisë së Doganave, Drejtorisë Tatimore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave Tiranë, me synim rritjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërinstitucional.
- Mbledhja e datës 12.12.2024 me Seksionin e Posaçëm dhe Seksionin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier mbi problematikat dhe përmirësimin dhe rritjen e rezultateve në punë.

Po ashtu, nga drejtuesi i prokurorisë janë organizuar 30 (tridhjetë) mbledhje dhe takime pune me trupën e prokurorëve, oficerët e policisë gjyqësore, administratën, etj, nga të cilat 9 (nëntë) mbledhje me trupën e prokurorëve, 6 (gjashtë) takime pune me administratën, 5 (pesë) takime me oficerët e policisë gjyqësore të seksionit dhe pjesa tjetër takime pune apo mbledhje të përbashkëta me oficerët dhe prokurorë apo administratë, apo përfaqësuesit e seksioneve, etj, sipas nevojave dhe objektivave.

Në këto mbledhje është dhënë mendim mbi investimet dhe buxhetin e prokurorisë, janë diskutuar raporti vjetor i treguesve të prokurorisë, çështje të natyrës profesionale, prioritetet e punës së prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit, problematika të punës dhe nevoja për përmirësimin e tyre, etj.

• Në funksion të balancimit të ngarkesës dhe efektivitetit në punë, drejtuesi i Prokurorisë ka ndërhyrë me mekanizmat e duhur ligjorë duke përjashtuar herë pas here nga shorti prokurorë të caktuar për periudha të caktuara kohore. Janë nxjerrë 13 (trembëdhjetë) urdhra për përjashtimin nga shorti të prokurorëve, ndërsa për shkak të shkarkimit, komandimit dhe lejeve të barrë-lindjes të prokurorëve me qëllim dorëzimin, marrjen në dorëzim dhe rishortimin e çështjeve janë nxjerrë 5 (pesë) urdhra nga drejtuesi i Prokurorisë, që disiplinojnë dorëzimin dhe kalimin e kallëzimeve/procedimeve nga prokurorët e larguar tek prokurorët e tjerë në detyrë. Konkretisht, janë përjashtuar nga shorti:

- Prokurori Denis Hyka për periudhën 08.02.2024-15.02.2024; 26.06.2024-05.07.2024; 02.09.2024-07.09.2024; 09.09.2024-16.09.2024; 16.09.2024-23.09.2024; 20.12.2024-01.01.2025.
- Prokurori Ervis Alliaj për periudhën 26.06.2024-05.07.2024; 02.09.2024-07.09.2024; 09.09.2024-16.09.2024; 16.09.2024-23.09.2024;

• Gjithashtu, është nxjerrë urdhri i drejtuesit të prokurorisë nr.97, datë 08.11.2024 *“Për shortimin dhe ndjekjen e ngjarjeve të ndodhura dhe fakteve të kallëzuara, për të cilat nuk gjenden fashikujt e hetimeve/kallëzimeve penale”*, për prokurorët e larguar, për

të cilat është informuar Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si dhe është referuar në Prokurorinë kompetente për ndjekje penale.

3.1 Janë nxjerrë 14 (katërmëdhjetë) urdhra për krijimin e grupeve hetimore, 9 (nëntë) për çështje penale dhe 5 (pesë) për procedime/referime pasurore, për shkak të ngarkesës dhe kompleksitetit në veçanti të këtyre çështjeve.

3.2. Gjithashtu, nga drejtuesi i prokurorisë janë nxjerrë gjithësej 22 (njëzetë e dy) udhëzime jo të detyrueshme për çështje penale prioritare në fazën e kallëzimit penal dhe procedimit penal, për veprat penale të parashikuara nga nenet 289, 278, 329, 287, 110/a, 190, 189, 143/2, 259, dhe për një referim pasuror.

3.3. Në lidhje me kërkesat për informacion, nga drejtuesi i Prokurorisë është kërkuar në mënyrë vijuese informacion, pa cenuar pavarësinë funksionale të prokurorëve, në lidhje me veprat penale prioritare dhe jo vetëm. Konkretisht janë bërë 77 (shtatëdhjetë e shtatë) kërkesa për informacion për verifikimin e ecuresë së hetimeve të procedimeve/kallëzimeve penale dhe procedimeve pasurore. Çështjet/kallëzimet penale për të cilat është kërkuar informacion janë identifikuar mbi bazën e të dhënave statistikore, kohës së gjatë të hetimeve të çështjeve, veprave penale dhe subjektet prioritare që kanë qenë objekt hetimi në to, kërkesave/ankesave të subjekteve të ndryshme, si dhe mbi bazën e burimeve të tjera të hapura (media, etj). Konstatohet në disa raste se nga prokurorët e çështjes janë hasur vështirësi në dhënien e informacionit, sipas ligjit dhe udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm për shkak të numrit të lartë të procedimeve penale në hetim dhe në gjykim, apo dhe ushtrimit të detyrave të tjera. Në disa raste ka patur neglizhencë në dhënien e informacionit dhe nuk është kthyer përgjigje nga prokurorët.

3.4. Në lidhje me vijimin e rritjes së rolit aktiv të prokurorëve rezulton se ka rritje të kontrollit në drejtim të veprimtarisë së oficerëve të policisë gjyqësore përmes kërkesës në mbjedhjet e zhvilluara për përfundimin e hetimeve në afat. Në kuadër të rritjes së rolit aktiv të prokurorit janë marrë masa që prokurorët dhe veçanërisht drejtuesit e seksioneve, t'ju kërkojnë Oficerëve të Policisë Gjyqësore numrin e dosjeve dhe veprimeve hetimore që kanë kryer me qëllim balancimin e punës dhe rritjen e mundësisë për përfundimin e hetimeve në afat. Në funksion të monitorimit të ngarkesës së oficerëve dhe shpërndarjes së drejtë të saj, është përdorur formulari/kartela për trajtimin e materialit ku drejtuesi i Prokurorisë ka ngarkuar drejtuesit e seksioneve për të përcaktuar oficerin që do trajtojë çështjen dhe me qëllim për të balancuar punën ndërmjet oficerëve.

Ndër të tjera, prokurorët në raste specifike në kuadër të dosjeve të deleguara, kanë mbajtur procesvebaleve të kontrollit të detyrave të deleguara me qëllim konstatimin e shkeljeve apo vonesave gjatë veprimtarisë së oficerëve të policisë gjyqësore dhe përcaktimin e një afati të shkurtër kohor për realizimin e detyrave dhe përfundimin e hetimit.

Në vitin 2024 janë kryer procedurat e vlerësimit të oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë për vitin pararendës, që kanë ushtruar në mënyrë të plotë detyrën në këtë prokurori, nga të cilët 6 (gjashtë) oficerë të policisë gjyqësore janë vlerësuar “shumë mirë”, 6 (gjashtë) oficerë të policisë gjyqësore “mirë” dhe 1 (një) oficer i policisë gjyqësore “mjaftueshëm”.

Pavarësisht rritjes së kontrollit dhe mbikëqyrjes së punës së oficerëve të policisë gjyqësore, vlerësohet që prokurorët duhet të jenë më tepër aktivë në kontrollin dinamik

të punës dhe veprimeve hetimore të oficerëve të policisë gjyqësore, evidentimin për çdo rast të shkeljeve procedurale të kryera prej tyre apo shkeljen e afateve të caktuara për përfundimin e hetimeve, sidomos kur janë të përsëritur dhe me pasoja, si dhe të informojnë drejtuesin e Prokurorisë apo Komisionin e Policisë Gjyqësore për të filluar procedura disiplinore në rastet e parashikuara në ligj.

3.5. Përgjatë vitit 2024 është proceduar me paraqitjen e 3 (tre) kërkesave për fillimin e procedimit disiplinor për oficerët e policisë gjyqësore pranë Komisionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme, ku dy kërkesa ka qenë për oficerët e policisë gjyqësore të Komisariatit të Policisë Fier dhe 1 (një) kërkesë për oficer të policisë gjyqësore të Prokurorisë Fier, i cili paraqiti më pas kërkesë për dorëheqje nga detyra.

3.6. Me urdhrin e drejtuesit të prokurorisë nr.27, datë 12.03.2024, *“Për disa ndryshime në urdhrin nr.55, datë 23.06.2023 “Për ndarjen e Oficerëve të Policisë Gjyqësore” të seksionit të prokurorisë sipas prokurorëve”*, dhe urdhrin e drejtuesit të prokurorisë nr.58, datë 10.07.2024, *“Për disa ndryshime në urdhrin nr.55, datë 23.06.2023, “Për ndarjen e Oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksionit të prokurorisë sipas prokurorëve”*, dhe urdhrin e drejtuesit të prokurorisë nr.86, datë 01.10.2024, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr.55, datë 23.06.2023 “Për ndarjen e Oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve të prokurorisë sipas prokurorëve” dhe marrjen e masave shtesë për mirëfuzionimin e Prokurorisë Fier”*, është bërë një rishpërndarje e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë nëpër seksione dhe sipas prokurorëve, kryesisht ndikuar nga dinamika e lëvizjes së prokurorëve të ardhur apo larguar nga Prokuroria Fier. Në këtë ndarje është mbajtur në konsideratë specializimi i tyre dhe veçanërisht është treguar kujdes që oficerët që kanë pasur përvojë të mëparshme në seksionin e posaçëm apo në seksionin për të mitur, të caktohen në këtë seksion.

3.7 Një kujdes i veçantë është treguar në respektimin e të drejtave dhe garancive procedurale të subjekteve të përfshirë në procesin penal, si në drejtim të njoftimit të tyre për të drejtat që gëzojnë, bërjen e tyre efikase nga prokurorët apo oficerët e policisë gjyqësore, si nëpërmjet njoftimeve për veprimet procedurale për garancitë që lidhen me caktimin e mbrojtësit në rastet e kërkuara, sipas parashikimeve ligjore. Nga praktika gjatë vitit 2024, përgjithësisht nuk janë evidentuar raste që gjykatat apo institucionet e tjera të kenë evidentuar shkelje të këtyre garancive me pasojë për procesin.

Në lidhje me të miturit, për këtë kategori është treguar një kujdes i shtuar me qëllim mbrojtjen e interesit më të lartë të tyre në një konflikt me ligjin apo viktimë e veprës penale. Kjo gjë është bërë e mundur edhe me ekzistencën e seksionit të të miturve, ku janë caktuar prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, të cilët kanë pasur eksperiencë të gjatë, përvojë të mëparshme dhe janë trajnuar në këtë fushë.

3.8. Gjithashtu, edhe për viktimat e veprës penale është treguar kujdes i veçantë në respektimin e garancive që atyre u njeh Kodi i Procedurës Penale nëpërmjet njoftimeve të vendimeve dhe veprime procedurale të kryera dhe ofrimit të atyre të drejtave që ju njeh ligji në çdo fazë të procedimit.

3.9. Në zbatim të ligjit nr. 97/2016, *“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, dhe udhëzimeve të përgjithshme nr. 17/2020 dhe nr. 5/2019, të Prokurorit të Përgjithshëm, koordinatori i subjekteve me status të posaçëm, ka marrë pjesë në 176 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) raste asistimi në veprimet proceduriale ku përfshihen viktimat e veprave penale me subjekt status të

posaçëm dhe të miturit në konflikt me ligjin, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave të viktimave në procesin penal dhe duke qenë pjesë e organikës së Prokurorisë, asistimi i tyre ka qenë i menjëhershëm, duke lehtësuar punën e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në trajtimin e tyre.

Në zbatim të dispozitave të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 5, datë 26.10.2018, "*Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale*", ku parashikohet krijimi i Sektorit të Asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm, i përbërë nga një koordinator viktimash, është zbatuar me korrektesë, pavarësisht mungesës së ambienteve të mjafueshme të punës në Prokurori. Koordinator i viktimave vazhdon të ushtrojë funksionet e veta në një ambient të posaçëm dhe të arregjuar posaçërisht për pritjen e viktimave të veprave penale, veçanërisht të të miturve dhe për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar, i cili ndodhet në katin e parë të Prokurorisë.

Gjithashtu, vëmendje i është kushtuar udhëzimit për parandalimin e viktimizimit të përsëritur dhe riviktimizimit të viktimave të cilët kanë pasur kontakte me Prokurorinë. Në funksion të këtij parimi, koordinatori bën të mundur koordinimin ndër-institucional me institucionet shtetërore të nivelit vendor dhe organizatat jo fitimprurëse me qëllim ofrimin e asistencës së qëndrueshme të viktimave të veprave penale sipas nevojave specifike të rasteve.

Gjatë vitit 2024 i është kushtuar vëmendje e veçantë zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 17, datë 23.12.2021, "*Për hetimin dhe ndjekjen efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejti*", dhe qarkores së drejtuesit të Prokurorisë datës 08.09.2023 nxjerrë për zbatimin me korrektesë të këtij udhëzimi.

Gjatë marrjes së të dhënave nga gruaja viktimë e dhunës ose viktimë e dhunës në familje është mbajtur në konsideratë asistimi i viktimës nga koordinatori i viktimave të veprave penale pranë prokurorisë, si dhe është bërë i mundur referimi i viktimës për të marrë shërbime socio-ekonomike pranë njësive të qeverisjes vendore apo organizatave joqeveritare.

Gjatë gjithë procesit është bërë e mundur njohja dhe respektimi i plotë i të drejtave të viktimave nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore si dhe koordinatori, informimi i viktimës së veprës penale dhe përfitimi i të drejtave të garantuara ligjore.

Në funksion të mbarëvajtjes së punës dhe garancive ligjore, ka patur bashkëpunim ndër-institucional mes Prokurorisë Fier dhe institucioneve të tjera si, strukturave të Policisë, Bashkive, Shërbimit Social, Zyra të Punës, Qendrës me një ndalesë, etj. Nga Prokuroria Fier është garantuar qëndrueshmëria dhe pjesëmarrja e koordinatorit në takimet e ETN-në/MKR-së, ku është respektuar angazhimi i marrë përsipër për çështjet e ngritura në takime.

Në kuadër të masave efektive për mbrojtjen e viktimave nga vepra penale e dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve është rritur bashkëpunimi me të gjitha bashkitë e përfshira në Qarkun Fier. Veçanërisht në Bashkinë Fier në raste konkrete është ngarkuar Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve me këshillimin jo vetëm të të miturit, por edhe të familjes, siç dhe është përcaktuar nga Zyra e Shërbimit të Provës.

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet dhe trajtimin të çështjeve të veçanta, janë bërë mbledhje mes Njesisë së Mbrojtjes për Fëmijët, koordinatorit të

Prokurorisë, psikologut të shkollës, inspektorit të policisë së zonës në varësi të rasteve etj. Në mënyrë periodike janë bërë mbledhje për problematikat e konstatuara në kuadër të Mekanizmit të Koordinimit të Rasteve të Dhunës në Familje dhe të rasteve të Miturve.

4. Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, ashtu si edhe në vitet e kaluara, raportet me institucionet e tjera kanë qenë korrekte dhe institucionale, në zbatim të ligjit procedural, ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e organeve përkatëse dhe atij organik për Prokurorinë. Në këto marrëdhënie rolin kryesor e zënë ato, që lidhen me:

- *Prokurorinë e Përgjithshme dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë.*
- *Strukturat e Policisë së Shtetit dhe institucionet e tjera që kanë shërbime të policisë gjyqësore.*
- *Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për fazën që lidhet me përfaqësimin e akuzës në gjykim, me paraqitjen në seancat paraprake si në rastet e kërkesave për pushim, ashtu edhe në ato për gjykim, si dhe me kërkesat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale.*
- *Prokurorinë dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për fazën që lidhet me përfaqësimin e akuzës në çështjet e ankimuara, me njoftimin e vendimeve apo akteve të cilat kanë ekzekutim të menjëhershëm.*
- *Institucionin e Ekzekutimeve të vendimeve Penale Fier, për kërkesat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale të formës së prerë.*
- *Zyrat e Shërbimit të Provës Fier dhe Lushnjë, për ekzekutimin e vendimeve të dënimit që mbikqyren nga shërbimi i provës.*
- *Komisionin e Policisë Gjyqësore dhe Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorinë e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.*
- *Institucione të tjera në nivel qendror dhe lokal.*

5. Në raport me Prokurorin e Përgjithshëm dhe drejtoritë e sektorët pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka patur një raport shumë të mirë dhe të ngushtë bashkëpunimi, që konsiston në gadishmërinë e plotë për bashkëpunim dhe ndihmë nga Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtoritë/sektorët përkatëse për zbatimin dhe përmbushjen e të gjithë detyrimeve ligjore me përpikmëri, vlerësimin në kohë dhe me objektivitet të kërkesave të Prokurorisë Fier. Bashkëpunimi i sektorëve të ndryshëm brenda institucionit tonë (si zyra e regjistrit, arkiva, kryesekretaria), ka bërë të mundur raportimin e materialeve voluminoze me të dhëna të detajuara, sipas kërkesave të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme nuk ka referuar asnjë rast. Nga viti 2023 është mbartur në hetim një procedim i referuar në vitin 2023 për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve, është kërkuar në gjykatë pushimi i këtij procedimi penal.

6. Në raport me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, si dhe institucione të tjera në nivel lokal, raportet kanë qenë shumë të mira dhe konsistojnë në gadishmërinë e plotë për bashkëpunim dhe ndihmë për zbatimin e të gjithë detyrimeve ligjore përkatëse.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vlerësuar objektivisht dhe në kohë nevojat e Prokurorisë Fier, duke plotësuar vendet e lira të përhershme me prokurorë të rinj, si dhe përmes një transferimi të përkohshëm. Aktualisht kanë mbetur pa plotësuar 3 (tre) vende vakante të përhershme dhe 6 (gjashtë) vende vakante të përkohshme për shkak të problematikave të krijuara kryesisht nga zbatimi i procesit “vetting”. Në funksion të mirëfunksionimit të institucionit, është kërkuar edhe plotësimi i vendit të kancelarit të Prokurorisë Fier, si një pozicion shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punëve administrative të Prokurorisë Fier, i cili mbetet i paplotësuar prej vitesh.

7. Në raport me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Sektorin e Monitorimeve në Prokurorinë e Përgjithshme, bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë. Lidhur me forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Sektorin e Monitorimeve në Prokurorinë e Përgjithshme, në lidhje me shkeljet individuale të magistratëve rezulton se, përgjatë vitit 2024, drejtuesi i Prokurorisë ka dërguar disa informacione në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë për konstatimet mbi çështjet/kallëzimet e trajtuara për 2 (dy) magistratë.

7.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Jurisdiksionit të Përgjithshëm Fier ka vijuar forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në lidhje me kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike për zbatimin e udhëzimeve me karakter të përgjithshëm.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Jurisdiksionit të Përgjithshëm Fier ka qenë objekt inspektimi nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, me temë: “*Mbi caktimin e çështjeve në Prokurori*”. Me vendimin nr. 9, datë 22.04.2024, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë ka përfunduar inspektimin tematik dhe grupi i inspektimit ka hartuar raportin e inspektimit tematik të Prokurorive në zbatim të vendimit nr.6/2, datë 28.02.2023, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili është dërguar për njoftim në Prokurorinë Fier.

7.2. Gjithashtu Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në ushtrimin e funksioneve ligjore dhe në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij, me vendimin nr.23, datë 15.05.2024, ka vendosur për kryerjen e inspektimit tematik me objekt, “*Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023*”. Po ashtu, me vendimin nr. 22, datë 15.05.2024, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është vendosur kryerja e inspektimit tematik, me objekt “*Mbi caktimin e çështjeve në Prokurori*”, për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023. Pas përpunimit dhe vlerësimit të informacioneve të nevojshme në kuadër të këtyre inspektimeve tematike, do të dorëzohen raportet përfundimtare të inspektimeve brenda afatit të përcaktuar.

8. Lidhur me bashkëpunimin me institucione të tjera të pavarura si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Kontrollit të Lartë Shtetit, Avokatit të Popullit dhe Avokaturës së Shtetit, konstatohet se nuk ka pasur referime për vepra penale nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Kontrollit i Lartë Shtetit, ndërsa bazuar në rekomandimet e Avokatit të Popullit për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe mjedisit nga ndotja e hidrokarbureve në zonën e Patos-Marinëz dhe qytetet përreth, është regjistruar një procedim penal për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i

K.Penal, i cili është në hetim. Në raport me Avokaturën e Shtetit janë zbatuar detyrimet ligjore.

9. Në raport me strukturat e policisë së shtetit, që përbën një element shumë të rëndësishëm të suksesit në punën e prokurorisë, është synuar rritja e bashkëpunimit. Bashkëpunimi i mirë ka funksionuar si në nivel drejtuesish ashtu edhe në nivelin bazë dhe ka dhënë rezultat në disa procedime penale. Theksi është vënë në përmbushjen e detyrimeve të policisë gjyqësore, rritjen e nivelit profesional dhe ndërgjegjësimin të tyre, eliminimin e zvarritjeve të pajustificuara dhe rritjen e cilësisë së hetimit me qëllim për të qënë më të suksesshëm në parandalimin dhe goditjen, sidomos të veprave penale më të përhapura në qarkun e Fierit.

Në funksion të sigurimit të zbatimit të rekomandimeve prioritare janë marrë një sërë masash. Konkretisht, janë organizuar dhe zhvilluar 13 (trembëdhjetë) mbledhje tematike me prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe drejtuesit e strukturave të Policisë së Shtetit me qëllim rritjen e efikasitetit të hetimit dhe respektimin e normave procedurale, rritjen e angazhimit dhe përfundimin e çështjeve penale të mbartura dhe kryesisht atyre që janë më të vjetra, etj.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional është punuar kryesisht për forcimin e bashkëpunimit me shërbimet e policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit si dhe në institucionet e tjera shtetërore të cilave ligji i posaçëm u njeh funksionet e Policisë Gjyqësore, sipas Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar.

10. Në raport me pushtetin vendor dhe institucionet e tjera lokale ka patur bashkëpunim korrekt dhe në përputhje me ligjin, me synimin për të marrë prej tyre në kohë informacionin e nevojshëm në interes të hetimit. Raporti me këto institucione dhe entet e tjera shtetërore vazhdon të jetë institucional dhe i ndërsjellë.

Për sa i përket bashkëpunimit me institucionet shtetërore, nga drejtuesi i prokurorisë është kërkuar në mënyrë vijuese rritja e bashkëpunimit, nxjerrja e problematikave që lidhen me hetimet, dhe për këtë qëllim janë organizuar takime të përbashkëta me drejtuesit e shërbimeve policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Vlorë, Drejtorisë së Hetimit Tatimor, Drejtorisë së Hetimit Doganor, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Fier - Berat, dhe me struktura të tjera, si Institutin e Policisë Shkencore, Institutin e Mjekësisë Ligjore, Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Fier, etj, me qëllim nxitjen dhe arritjen e rezultateve konkrete.

11. Rëndësi dhe vëmendje e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit me Prokurorinë e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit. Gjatë vitit 2024, Prokurorisë së Posaçme i janë dërguar për kompetencë lëndore 9 (nëntë) procedime penale: tre për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, dy për veprën penale të parashikuar nga neni 79 gërma “ë” të Kodit Penal, një për veprën penale të parashikuar nga neni 289/2 i Kodit Penal, një për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/4, një për veprën penale të parashikuar nga neni 259/2 i Kodit Penal dhe një për veprën penale

të parashikuar nga neni 245/1 prg. 2 dhe 4 të Kodit Penal. Në raste të specifike është komunikuar dhe koordinuar drejtpërdrejt në interes të hetimeve.

12. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, në përputhje me ligjin u janë dërguar autoriteteve të drejtësisë së shteteve të huaja një numër i konsiderueshëm kërkesash për ndihmë juridike, kryesisht që lidhen me hetimin e procedimeve penale të regjistruara për nenin 287 të Kodit Penal. Rezulton se ka patur përvoja pozitive në disa raste, pasi përgjigjet nga autoritetet e huaja të drejtësisë janë kthyer brenda një afati të arsyeshëm dhe konform marrëveshjeve ndërkombëtare.

Vlen të theksohet se gjatë këtij viti është bashkëpunuar në raste që ka qenë e nevojshme edhe me prokuroren ndërlidhëse shqiptare në EUROJUST dhe me Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme. Kjo formë bashkëpunimi ka rezultuar e frytshme në drejtim të rezultave të kërkuara.

13. Nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore janë kryer trajnime pranë Shkollës së Magjistraturës, për tema të ndryshme, në kuadër të programit të trajnimit vazhues që zhvillon Shkolla e Magjistraturës, por edhe nga Zyra e Bashkimit Evropian për tema të ndryshme si:

- *Gjykimi në mungesë si shkak ligjor i rigjykimit nëpërmjet rivendosjes dhe rishikimit.*
- *Hetim Proaktiv. Kuadri Ligjor. Burimet e informacionit për hetimin kriminal të bazuara në inteligjencë. Procedura që ndiqet për regjistrimin dhe ecurinë proaktive. Standartet dhe praktikat e mira ndërkombëtare.*
- *Gjykimi në mungesë në seancë paraprake dhe në themel.*
- *Aftësitë e kontabilitetit.*
- *Për inspektimin, hetimin dhe ndjekjen penale të kundërvajtjeve dhe krimeve mjedisore.*
- *Viktima si subjekt i procesit penal. Pozita procedurale e viktimës. Roli i tij në fazën e hetimit dhe gjykimit. E drejta për kompensim dhe mungesa e legjislacionit vendas.*
- *Pastrimi i parave.*
- *Zgjerimi dhe fuqizimi i Sistemit të Ndërmjetësimit në Shqipëri. Mekanizmi i Referimit të Çështjeve në Ndërmjetësim për të Miturit.*
- *Tryezë e Rrumbullakët e Drejtësisë për Raportimin mbi Dhunën me Bazë Gjinore: Qasja me në qendër Viktimën/të mbijetuarën.*
- *Përgjimet procedurale dhe parandaluese. Kufijtë e lejimit të përgjimit. Regjistrimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave. Praktika gjyqësore.*
- *Ekspertimi, kushtet e vlefshmërisë dhe përdorshmërisë.*
- *Kontrolli i vendeve dhe i personave. Kushtet për kryerjen e kontrollit.*
- *Zbatimi i marrëveshjes ndërmjet R.Sh dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë dhe Irlandës së Veriut për transferimin e personave të denuar.*
- *Trafikimi i qënieve njerëzore, personave të rritur dhe të mitur.*
- *Monedhat virtuale dhe krimi kibernetik.*
- *Njohja e personave si mjet kerkimi te provave. Analize praktike gjyqësore dhe ndërkombetare mbi njohjen e personit.*

pronës apo ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin, dhunës në familje dhe krimeve seksuale, krimeve mjedisore, si dhe veprave penale prioritare në luftën kundër kriminalitetit, etj.

Në lidhje me problemet e hasura në kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të ligjit penal dhe procedural penal, metodikat e hetimit për vepra apo grupvepra penale në fushën e mjedisit dhe krimeve kibernetike apo ato në fushën e tatimeve dhe pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, vlerësohet e nevojshme të kryhen trajnime për hetimin e tyre në mënyrë sa më efektive.

14. Sa i përket masave të marra për përditësimin e vazhdueshëm të dhënave për procedimet/çështjet e pastrimit të parave dhe procedimet/hetimet pasurore nëpërmjet sistemit elektronik e-tracking PRESTO, si për vënien në efikasitet sa më të plotë të këtij sistemi elektronik, theksojmë se, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është bërë përpjekje për hedhjen, përditësimin dhe raportimin e vazhdueshëm. Me qëllim monitorimin dhe përditësimin e të dhënave të këtij sistemi elektronik, ka qënë e ngarkuar prokurorja Aida Cakaj, e cila njëkohësisht ka qënë edhe pika e kontaktit me Prokurorinë e Përgjithshme.

Në fillim të vitit 2024 është kërkuar hapja e userave të rinj për prokurorët e caktuar në këtë seksion. Vlerësojmë se, lëvizjet e shpeshta të prokurorëve kanë krijuar problematikën e rihedhjes së të dhënave përsëri në sistemin PRESTO, ndërkohë që vlerësojmë se duhen gjetur zgjidhje më të shpejta dhe efektive kur sistemi duhet të lejojë kalimin e të dhënave që kanë qënë të hedhura nga prokurori që largohet, transferohet apo komandohet, tek prokurori i cili caktohet rishtazi për çështjen konkrete. Ky faktor vlerësojmë se ka vështirësuar punën e disa prokurorëve të cilët janë caktuar për hetuar një numër të lartë të verifikimeve/hetimeve pasurore apo procedimeve penale dhe për të cilat kërkohet rihedhja e tyre (rreth 120 çështje për të cilat është kërkuar të bëhet ky proces).

Nëse për çështjet e arkivuara nuk janë hedhur të dhënat lidhur me mënyrën e përfundimit dhe nuk është mbyllur çështja në sistemin PRESTO, ajo nuk mund të mbyllet nga një prokuror tjetër, i cili jo vetëm që nuk është prokurori i çështjes, por nuk ka akses në sistemin e prokurorit të larguar. Për të shmangur qoftë edhe pjesërisht rihedhjen e të dhënave në sistemin PRESTO nga prokurorët e çështjeve të cilët kanë marrë një numër të lartë të çështjeve nga prokurorët e larguar, komanduar, transferuar, sugjerohet që të bëhet kalimi i të dhënave të sistemit në mënyrë automatike përmes transferimit, tek prokurorët aktual duke shmangur rihedhjen manualisht prej tyre.

Prokurorët që kanë marrë çështje nga prokurorët e larguar ose kur marrin çështje të reja, në hetim dhe gjykim, janë njoftuar që në rastin e procedimeve penale për nenet 287 dhe 287/b të Kodit Penal, dhe referimet pasurore sipas ligjit “antimafia”, duhet të bëjnë sa më shpejt regjistrimin e tyre në sistemin “PRESTO”. Është sugjeruar që regjistrimi të bëhet përpara se dosjet hetimore të delegohen dhe të kryhet përditësimi i të dhënave.

Prokurorët e caktuar rishtazi në Seksionin e Posaçëm janë informuar se, raportimi i të dhënave statistikore 3 (tre) mujore në Prokurorinë e Përgjithshme, kërkon që prej tyre të posedohen të dhënat elektronike për numrin e procedimeve penale në hetim dhe gjykim për nenet 287 dhe 287/b të Kodit Penal, si dhe të dhënat lidhur me numrat e verifikimeve/procedimeve pasurore. Prokurorët janë orientuar që çdo tre muaj, në datat

- *Kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes, shqyrtimi i saj, revokimi i vendimit të pushimit të akuzës dhe çështjes.*
- *Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale.*
- *Lirimi me kusht. Roli dhe bashkëpunimi mes institucionit të prokurorisë, gjykatës, shërbimit të provës, burgjeve, policisë dhe komunitetit.*

Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë kanë marrë pjesë në trajnime si më poshtë²:

- *Elion Mustafaj 5 (pesë) trajnime;*
- *Prokuror Petrit Vukaj 5 (pesë) trajnim;*
- *Prokurore Elida Hoxhaj 6 (gjashtë) trajnime;*
- *Prokurore Aida Cakaj 5 (pesë) trajnime;*
- *Prokuror Genci Mane 7 (shtatë) trajnime;*
- *Prokuror Denis Hyka 10 (dhjetë) trajnime;*
- *Prokuror Leonard Suçi 9 (nëntë) trajnime;*
- *Prokuror Ervis Alliaj 4 (katër) trajnime;*
- *Prokurore Jonida Allushi 6 (gjashtë) trajnime;*
- *Prokurore Elona Gixhari 5 (pesë) trajnime;*
- *Prokurore Redona Ndoni 2 (dy) trajnime;*
- *Prokurore Lorena Salillari 4 (katër) trajnime;*
- *Prokurore Olliana Gjergjefti 4 (katër) trajnime;*
- *Prokurore Greta Dreni 3 (tre) trajnime;*
- *Prokurore Blerina Musabelliu 5 (pesë) trajnime;*
- *Prokuror Kristi Jorgji 3 (tre) trajnime;*
- *Oficer e policisë gjyqësore Ameli Kararaj 5 (pesë) trajnime;*
- *Oficer i policisë gjyqësore Fotion Malaj 6 (gjashtë) trajnime;*
- *Oficer i policisë gjyqësore Brixhilda Sinjari 2 (dy) trajnime;*
- *Oficer i policisë gjyqësore Dorjan Hoxha 5 (pesë) trajnime.*

Nga Drejtuesi i Prokurorisë janë kërkuar dhe mundësuar zhvillimi i takimeve të vazhdueshme me strukturat dhe agjencitë shtetërore me qëllim bashkëpunimin institucional dhe për një kooperim sa më të shpejtë dhe efektiv me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit, përmirësimin e cilësisë së referimeve, akteve, relacioneve, hetimeve, mënyrën dhe shpejtësinë e komunikimit mes oficerëve dhe prokurorëve, hartimin e raportimeve sipas Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me urdhër të drejtuesit të prokurorisë, nga Prokuroria Fier janë organizuar 3 (tre) trajnime me Oficerët e Policisë Gjyqësore të seksionit të Prokurorisë dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore të Shërbimeve të Drejtorisë Vendore të Policisë dhe Komisariateve të Policisë në varësi të kësaj Drejtorie. Trajnimet janë kryer nga prokurorë të caktuar të Prokurorisë Fier. Në këto trajnime u është kushtuar rëndësi veprave penale me karakter pasuror dhe ato që lidhen me cenimin e interesave të

² Bazuar në raportimet e bëra nga secili prej prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

10 Janar, 10 Prill, 10 Korrik dhe 10 Tetor, të përditësojnë të dhënat dhe secili prokuror të informojë Drejtuesin e Seksionit të Posaçëm përmes postës elektronike lidhur me numrin e procedimeve të hedhura në sistem, numrin e verifikimeve/hetimeve pasurore, në mënyrë që të bëhet më pas rakordimi i saktë i të dhënave në total, të hedhura në sistemin PRESTO, si për nenet 287 dhe 287/b të Kodit Penal, ashtu edhe për verifikimet pasurore.

Në muajin Prill 2024 janë njoftuar prokurorët përmes postës elektronike që në rastet kur kërkojnë në gjykatë dërgimin për gjykim apo pushimin e çështjes për veprat penale të parashikuara nga nenet 287 dhe 287/b të Kodit Penal, si dhe kërkesat për sekuestrim dhe konfiksime në rastet e procedimeve pasurore, t'i dorëzojnë Drejtuesit të Seksionit të Posaçëm, kopje të kërkesës si dhe të vendimit gjyqësor.

Nga ana e Drejtuesit të Seksionit të Posaçëm është zhvilluar mbledhja e datës 13.09.2024, e cila, ndër të tjera, ka pasur si objekt plotësimin e sistemit PRESTO duke angazhuar edhe oficerët e çështjeve që i kanë dosjet nën hetim.

Lidhur me të dhënat e regjistrit të hetimeve pasurore përgjatë vitit 2024 është synuar që të përditësohen të dhënat për dosjet e rishpërndara të prokurorëve që janë larguar si pasojë e transferimeve, shkarkimeve për shkak të procesit të rivlerësimit apo të komandimeve. Janë bërë përpjekje që të dhënat të hidhen në një "database" elektronik të përditësuar, ku të shënohen emrat e prokurorëve aktual, numri përkatës i materialit, emri i subjektit, cilat janë arkivuar dhe cilat janë efektivisht në hetim apo verifikim. Për të realizuar këtë, janë njoftuar prokurorët dhe oficerët e caktuar në prokurori dhe 3 (tre) seksionet përkatëse pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier për të identifikuar dosjet që kanë nën hetim dhe emrat e prokurorëve që i kanë deleguar këto çështje. Ky proces pothuajse është përfunduar, duke përjashtuar një numër të vogël për të cilët po vijon verifikimi i tyre.

15. Në lidhje me zbatimin e memorandumit të mirëkuptimit nr. 1460 prot., datë 30.09.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm nr.15, datë 30.10.2020, *"Për trajtimin e njoftimit nga viktimat akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elemente të veprës penale"*, ku parashikohen qartë mënyra e veprimit. Për këto arsye, janë organizuar takime të përbashkëta pune me shërbimet e policisë gjyqësore dhe trupën e prokurorëve. Po ashtu, u është kërkuar shërbimeve të policisë gjyqësore për zbatimin me korrektesë të memorandumit të mirëkuptimit nr. 1460 prot., datë 30.09.2020 dhe udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm, duke u kthyer për plotësim disa nga referimet e mbajtuara jo në formën e duhur. Pas sensibilizimit dhe trajnimeve/takimeve të zhvilluara janë vërejtur ndryshime pozitive dhe pothuajse janë tejkaluar problemet.

II. TREGUESIT E HETIMIT DHE VOLUMIT TË PUNËS PËR VITIN 2024

◦ Kallëzimet penale për vitin 2024 dhe kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale.

Duke zbatuar detyrimin kushtetues si autoriteti i vetëm për ushtrimin e ndjekjes penale, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka qenë e angazhuar për të kryer një hetim sa më të plotë dhe të gjithanshëm për të gjitha

procedimet e trajtuara gjatë këtij viti brenda një afati të arsyeshëm, për të ngritur dhe përfaqësuar sa më mirë akuzën në gjykim, për të ekzekutuar në kohë vendimet penale të gjykatave dhe për të mbikëqyrur në vazhdimësi vuajtjen e dënimit të të dënuarve.

Në vitin 2024 janë regjistruar **2438 kallëzime penale** të referuara nga:

Policia e shtetit	2155
Polici të tjera	34
Nëpunës	42
Shtetas	89
Hetimi tatimor	4
OPGJ Seksioni i Prokurorisë	53
Kryesisht/ndarë	61
Totali	2438

Për sa i përket referimeve nga Policia e Shtetit të dhënat vijnë si më poshtë:


<i>Referuar nga:</i>	<i>Numri</i>
Drejtoria e Policisë Qarku Fier	784
Komisariati i Policë Fier	672
Komisariati i Policë Lushnjë	415
Komisariati i Policë Divjakë	133
Komisariati i Policë Mallakastër	112
Policia e shtetit (DVP/KP të tjerë)	39

Në lidhje me njoftimet/raportimet e qytetarëve për korrupsion, nuk rezulton i regjistruar asnjë rast apo raportim.

Lidhur me kriminalitetin sipas shtrirjes tokësore, ajo që vihet re është se Drejtoria Vendore e Policisë Fier dhe Komisarati i Policisë Fier kanë numrin më të madh të referimeve. Referimet nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier përfshijnë kryesisht vepra penale të tilla si: “*Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor*”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, ku numrin më të madh të referimeve e zënë raste të ndodhura në territorin e rrethit të Fierit, për të vijuar me rrethin e Lushnjës, Divjakës.

- **Kriminaliteti sipas peshës së përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre**

PËRHAPJA E VEPRAVE PENALE NË VITIN 2024



Ndërsa figurat e veprave penale më të përhapura kanë qenë:

- “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, e parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, me 340 procedime penale.
- “Vjedhja”, e parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, me 334 procedime penale.
- “Dhuna në familje”, e parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, me 184 procedime penale.
- “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, me 118 procedime penale.
- “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, me 106 procedime penale.
- “Ndërtimi i paligjshëm”, e parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, me 94 procedime penale.
- “Plagosja e lehtë me dashje”, e parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, me 77 procedime penale.

◦ **Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (kundërvajtje-krime).**

Për sa i përket natyrës së veprave penale të hetuara, konstatohet se 90 % e veprave penale janë krime, ndërsa vetëm 10 % e tyre janë kundërvajtje penale. Pra, rezulton se vetëm 206 procedime penale janë kundërvajtje penale, nga 2042 procedime penale të regjistruara të reja në vitin 2024.

▪ **HETIMI**

Në vitin 2024 janë regjistruar në total 2086 (dymijë e tetëdhjetë e gjashtë) procedime penale të reja me 904 (nëntëqind e katër) persona në hetim dhe të pandehur, nga të cilat 37 (tridhjetë e shtatë) procedime penale me 14 (katërmbëdhjetë) persona në hetim/të pandehur kanë ardhur për kompetencë nga prokuroritë e tjera.

Në vitin 2024 janë bashkuar 16 nga procedimet penale të mbartura nga viti paraardhës (2412+16=2428); dhe 44 procedime penale të regjistruara të reja (2005+44+37=2086). Numrit të procedimeve të vitit 2023 i janë shtuar edhe 69 procedime penale të bashkuara në këtë vit.

Sqarojmë gjithashtu se, numri i procedimeve të mbartura dhe që janë regjistruar rishtazi në vitin 2024 nuk përputhen me të dhënat e raportuara në statistikën vjetore, pasi në formularët statistikorë nuk raportohen procedimet e bashkuara, duke qenë se nuk ka kolonë të posaçme për këtë kategori.


Tabela e mëposhtme tregon të dhënat krahasuese mes viteve 2023 dhe 2024

	Mbartur nga viti paraardhës				Regjistruar					Rifilluar			
	Procedime	Persona nën hetim	Të pandehur	Arrest në burg	Kallëzime	Procedime	Persona nën hetim	Të pandehur	Arrest në burg	Procedime	Persona nën hetim	Të pandehur	Arrest në burg
2023	2379	226	553	153	2533	2129	413	507	218	14	3		
2024	2428	201	470	105	2483	2086	367	537	243	14		1	

Të dhënat për mënyrën e përfundimit vijnë si më poshtë:

	Procedime të përfunduara	Dërguar në gjyq	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Të pandehur	Persona nën hetim	Arrest në burg	Mbartur në vitin pasardhës	Persona nën hetim	Arrest në burg
2023	2062	912	635	484	31	1071	654	371	2391	461	208
2024	2363	881	1019	437	26	1011	579	349	2105	383	141

Më poshtë paraqitet grafikisht krahasimi mes numrit të çështjeve të përfunduara gjatë viteve 2023 dhe 2024, sipas mënyrës së përfundimit:



Shpjegojmë se, për nxjerrjen e numrit të procedimeve penale të mbartura në vitin 2025, nuk janë llogaritur 60 procedimet e bashkuara duke qenë se në statistikë lidhur me mënyrën e përfundimit, ato raportohen si një çështje e vetme.

Tabela e mëposhtme pasqyron të dhënat totale për çështjet në hetim dhe të përfunduara në vitin 2024, si dhe të çështjeve penale të mbartura në 2025, sipas krerëve të Kodit Penal.

2024		Kreu II	Kreu III	Kreu IV	Kreu VIII	Kreu IX	Kreu X
TOTALI NË HETIM	Çështje	905	1677	64	1654	162	6
	Person nën Hetim	136	130	4	283	26	0
	Pandehur	213	199	7	541	50	1
	Arrest. burg	122	66	0	135	26	0
PËRFUNDUAR	Çështje	497	832	36	904	92	2
	Person nën Hetim	39	27	1	123	5	0
	Pandehur	213	199	7	541	50	1
	Arrest. burg	77	42	0	70	19	0
MBETUR NË HETIM NË 2025	Çështje	408	845	28	750	70	4
	Person nën Hetim	97	103	3	160	20	0
	Pandehur	0	0	0	0	0	0
	Arrest. burg	45	24	0	65	7	0

Të ndara, mënyrat e përfundimit të çështjeve sipas krerëve paraqiten si më poshtë:

Kreu	Kre.II	Kre.III	Kre.IV	Kre.V	Kre.VI	Kre.VII	Kre.VIII	Kre.IX	Kre.X
Dërguar në gjyq	189	165	4	0	0	0	480	42	1
Pushuar	279	284	25	0	0	0	380	50	1
Pezulluar	23	373	7	0	0	0	34	0	0
Transferuara	6	10	0	0	0	0	10	0	0

• Procedimet e dërguara për gjykim

Në vitin 2024 është kërkuar dërgimi për gjykim, miratimi i urdhrin penal dhe i marrëveshjeve të fajësisë për 881 (tetëqind e tetëdhjetë e një) procedime penale, me 999 (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) të pandehur, nga të cilët 205 (dyqind e pesë) të pandehur me masën e sigurimit “arrest në burg”. Këto procedime penale përbëjnë rreth 37,2% të numrit të përgjithshëm të procedimeve penale të përfunduara (llogaritja është bërë duke marrë në konsideratë të gjitha çështjet e përfunduara: dërguar gjyqit+të pushuara+të pezulluara+të transferuara).

Në vitin 2024 është kërkuar gjykimi i drejtpërdrejtë vetëm për 55 (pesëdhjetë e pesë) procedime penale, të cilat janë pranuar nga gjykata, ndërsa për kërkesat e tjera të dhënat janë si më poshtë:


Kërkesë për dërgim në gjyq		Vendimi i gjykatës			
Çështje	Të Pandehur	Pranim kërkesë	Pushim çështje ose akuze	Kthim aktesh	Dërgim në gjykatën kompetente
835	953	535	-	18	-

Miratim urdhri penal		Vendimi i gjykatës			Marrëveshje fajësie		Vendimi i gjykatës		
Çështje	Të Pandehu	Miratim urdhri	Pushim çështje	Refuzim urdhri e kthim aktesh	Çështje	Të Pandehur	Miratim marrëveshje	Pushim çështje	Refuzim marrëveshje kthim aktesh
2	2		1 ³	1	44	44	23	-	7

Sikurse vërehet, treguesit e çështjeve të dërguara në gjyq janë në parametra pozitivë duke iu përmbajtur gjithmonë parimit për të dërguar në gjyq ato procedime penale për të cilat ka patur prova të mjaftueshme për ngritjen e akuzës. Nga procedimet penale të dërguara për gjykim pjesën kryesore e zënë procedimet e regjistruara mbi bazën e materialeve të referuara nga organet e Policisë së Shtetit, si dhe nga qytetarët.

Veprat penale që përbëjnë edhe numrin më të madh të çështjeve të dërguara në gjykim⁴ paraqiten si më poshtë:

VEPRA PENALE TË DËRGUARA PËR GJYKIM



³ Pushuar në zbatim të ligjit nr.33/2024 "Për dhënie amnistie".

⁴ Përfshihen kërkesat për dërgim në gjyq, marrëveshjet për pranimin e fajësisë dhe urdhrat penal.

Rezultoni se përqindja e procedimeve penale të dërguara për gjykim në vitin 2024 në raport me totalin e procedimeve të përfunduara është 7% më e ulët se në vitin 2023.

• **Të dhëna të përgjithshme mbi të pandehurit**

Nga 1011 të pandehur që janë regjistruar në vitin 2024, rezultoni se 961 të pandehur kanë qenë meshkuj dhe 50 të pandehur kanë qenë femra, nga të cilët 3 shtetas të huaj dhe 1008 shtetas shqiptarë. Pjesa më e madhe e të pandehurve janë me arsim të mesëm, 512 persona, me arsim të ulët 391 persona dhe me arsim të lartë 108 persona.

Në pjesën më të madhe, të përbërë nga 532 persona, të pandehurit janë të punësuar në sektorin privat, kryesisht të vetëpunësuar në bujqësi, 455 persona kanë qenë të papunë, 17 persona kanë qenë nëpunës dhe 7 persona kanë qenë punonjës policie. Për sa i përket gjendjes gjyqësore të tyre, 909 të pandehur kanë qenë të padënuar (duke përfshirë edhe të rehabilituarit) dhe 102 të pandehur kanë qenë përsëritës, nga të cilët 8 të pandehur përsëritës të posaçëm.

• **Procedimet e pushuara dhe për të cilat është kërkuar pushimi**

Për procedimet penale të regjistruara janë këto rezultate:

	Gjithsej	Mungesë fakti	Mungesë prove	Shkaqe të tjera	Persona nën hetim				
					Mungesë fakti	Mungesë prove	Shkaqe të tjera	Arrest në burg	Arrest në shtëpi
Procedim të pushuara	1019	68	29	922	14	11	159	-	-

Në zbatim të nenit 329/a, të Kodit të Procedurës Penale, është kërkuar pushimi i çështjes në gjykatë si më poshtë:

DËRGUAR GJYKATËS PËR PUSHIM ÇËSHTJE OSE AKUZE			VENDIMI I GJYKATËS			
Çështje	Persona nën hetim	Të Pandehur	Pushim çështje ose akuze	Kthim aktesh dhe vazhdim hetimi	Kthim aktesh dhe formulim akuze	Pa u shqyrtuar
610	100	9	326	52	3	229

Çështjet e pushuara zënë rreth 43,1% të numrit të përgjithshëm të çështjeve të përfunduara në periudhën një vjeçare, me një rritje nga viti i kaluar prej rreth 12,3 %. Kjo rritje ka ardhur edhe për shkak të zbatimit të ligjit nr. 33/2024, “Për dhënie amnistie”.

Numri më i madh i çështjeve të pushuara është “për shkaqe të tjera”, dhe përfshin çështjet e pushuara për shkak të zbatimit të ligjit nr. 33/2024, “Për dhënie amnistie”, si

dhe çështjet ku është hequr dorë nga ankimi apo është tërhequr ankimi prej të dëmtuarave, kur ndjekja penale është e kushtëzuar me vullnetin e të dëmtuarave.

Në zbatim të ligjit nr. 33/2024, “Për dhënie amnistie”, janë pushuar 312 procedime penale me 40 persona nën hetim. Më poshtë paraqitet ndarja e procedimeve të pushuara në hetim, sipas veprave penale konkrete:

Neni	Çështje
84	33
89	46
91	3
126	2
149/a	1
157	1
159	2
170/a	1
199	3
199/a	47
200	25
205	3
207/a	4
207/c	1
235/1	1
236/1	3
242	11
247	1
262	1
272	1
273	8
274	1
275	27
277	31
278/3	1
280	8
297	12
305/B	2
320	9
320/a/1	1
321	2
321/2	19
322	1
Totali	312


Çështjet e pushuara “për mungesë fakti”, ku përfshihen si rastet kur është konstatuar që fakti nuk ekziston, ashtu edhe rastet kur fakti nuk përbën vepër penale, zënë 6,7% të çështjeve të pushuara. Duke analizuar procedimet e pushuara për mungesë të faktit, konstatohet se është i nevojshëm një verifikim paraprak dhe një vlerësim më i drejtë i fakteve të paraqitura në materialin kallëzues, por, në kushtet kur neni 291 i Kodit të

Procedurës Penale parashikon që prokurori ka vetëm 15 ditë afat nga data e regjistrimit të kallëzimit për të marrë një vendim lidhur me të, për çështjet që paraqiten të komplikuar ky afat është i pamjaftueshëm, prandaj procedohet me regjistrimin e kallëzimit si procedim penal dhe në përfundim të hetimeve vendoset ose kërkohet pushimi i hetimeve nëse jemi para rasteve të parashikuara nga neni 328, pika 1, i K.Pr.Penale.

Çështjet e pushuara për mungesë të provave zënë vetëm 2,8% të numrit të çështjeve të pushuara, çka tregon për përpjekjet e bëra për të provuar akuzat në ngarkim të personave ndaj të cilëve ushtrohet ndjekje penale.

Nga procedimet penale të pushuara, nuk ka pasur asnjë rast ku personi nën hetim të ketë qenë me masën e sigurimit “*arrest në burg*”, kurse me masën e sigurimit “*arrest në shtëpi*” kanë qenë tre procedime penale

Numrin më të madh të procedimeve të pushuara e zënë ato të regjistruar për veprat penale si më poshtë:



Rezulton se nga 1019 (njëmijë e nëntëmbëdhjetë) procedime penale të pushuara, për 409 (katërqind e nëntë) procedime penale është vendosur pushimi nga prokurori, kurse për 610 (gjashtëqind e dhjetë) procedime penale është kërkuar pushimi në gjykatë.

Në këto tregues vërehet se kemi një numër jo të vogël procedimesh penale, konkretisht 52 procedime, në të cilat Gjykata nuk ka pranuar kërkesat e prokurorëve për pushimin e procedimit penal, por ka vendosur kthimin e akteve në Prokurori dhe vazhdimin e hetimeve. Këto procedime përbëjnë 13,6% të numrit total të kërkesave për pushim të shqyrtuara nga gjykata në vitin 2024. Nga këto vendime vërehet se jo gjithmonë nga ana e Prokurorit dhe oficerit të Policisë Gjyqësore janë kryer hetime shteruese rreth faktit penal. Këto raste janë marrë në analizë në takimet me prokurorët mbi shkaqet e vendimmarrjes së gjykatës. Në këtë drejtim vlerësohet se prokurorët duhet të jenë më të vëmendshëm në kryerjen e hetimeve të plota dhe të gjithanshme.

• **Procedimet penale të pezulluara**

Në vitin 2024 janë pezulluar 437 (katërqind e tridhjetë e shtatë) procedime penale ose 18,5% e çështjeve të përfunduara. Në raport me vitin 2023, numri i procedimeve penale të pezulluara është 5% më pak. Numrin më të madh të procedimeve penale të

pezulluara e zënë ato të regjistruara për veprën penale “Vjedhja”, e parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, me 271 procedime penale.

Në lidhje me vendimet e pezullimit është synuar të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore, duke i kushtuar rëndësi të veçantë dhe nxitur kryerjen e veprimeve në vendin e ngjarjes, fiksimit të provave në formën e parashikuar në ligj, etj.

Vlerësohet se është e nevojshme që prokurori gjatë hetimeve paraprake të jetë më shumë drejtues dhe kontrollues, duke qenë me afër policisë në ngjarjet e rënda kriminale, por dhe duke kontrolluar në vazhdimësi ligjshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore nga ana e tyre.

Këtë vit janë rifilluar hetimet për 14 (katërbëdhjetë) procedime penale të viteve të mëparshme, të cilat kanë qenë të pezulluara për moszbulim autori.

Tabela me poshtë krahason numrin e procedimeve të pezulluara në vitet 2023 dhe 2024:

Shkaku i pezullimit	Viti 2023	Viti 2024
Autori nuk dihet	484 Procedime	437 Procedime
I pandehuri i sëmurë	-	-

Bazuar në të dhënat analitike, vihet re ulje e numrit total të procedimeve penale të pezulluara, krahasuar me vitin 2023, me 47 (dyzetë e shtatë) procedime penale. Gjatë vitit 2024, numri i procedimeve penale në hetim ka qenë pothuajse i njëjtë me atë të vitit 2023, me vetëm 6 procedime më shumë, ndaj ky numër më i ulët tregon se prokurorët kanë treguar një dilijencë më të madhe për kryerjen e veprimeve hetimore që kanë çuar në zbulimin e autorëve të veprave penale. Megjithatë, është e nevojshme që kjo dilijencë të rritet në mënyrë që numri i çështjeve të pezulluara të jetë edhe më i ulët.

• **Procedime penale të transferuara**

Në vitin 2024, janë transferuar 26 procedime penale, me 11 persona nën hetim, ku numrin më të lartë e zënë veprat penale si më poshtë:

Neni	Procedime
Neni 287/1/a	4
Neni 141/a/1	3

Të dhënat krahasuese për çështjet penale të transferuara për vitet 2023 e 2024.


Transferuar për moskompetencë		
	Viti 2023	Viti 2024
Çështje penale	31	26
Persona nën Hetim	4	11

• **Mosfillimet**

Në vitin 2024 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 364 kallëzime penale, ndër të cilat 333 (treqind e tridhjetë e tre) për vepra penale konkrete dhe 30 (tridhjetë) pa vepër penale konkrete. Për 4 (katër) kallëzime penale vendimet e mosfillimit janë shfuqizuar nga gjykata dhe urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, ndërsa për 2 (dy) kallëzime penale janë rifilluar nga vetë prokurori.

Vihet re një ulje e numrit të vendimeve për mosfillimin e procedimit penal në krahasim me vitin 2023, me 102 mosfillime më pak se viti 2023. Në këtë drejtim ka ndikuar fakti që shumë prej ngjarjeve janë trajtuar sipas memorandumit të mirëkuptimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Të ndarë sipas veprave penale, mosfillimet paraqiten si më poshtë:



Për të gjitha këto raste është treguar kujdesi i duhur që vendimi të merret pasi të jenë kryer verifikimet e nevojshme.

Rezulton se, në përgjithësi është respektuar afati 15 ditor i parashikuar nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale, por në jo pak raste nuk është respektuar ky afat. Në disa nga këto raste vonesat kanë ardhur për shkaqe objektive, siç është rasti i vonesave të akteve të ekspertimit, kryesisht mjeko-ligjore, dinamikës së lëvizjes së prokurorëve për shkak të largimit nga procesi i rivlerësimit kalimtar, etj, dhe ngarkesës në punë, kurse në disa raste të tjera vonesat kanë ardhur për neglizhencë të oficerëve të policisë gjyqësore të ngarkuar për të kryer verifikimet, si dhe vetë të prokurorëve. Mendojmë se politika e ndjekur në rastet e vendimeve të mosfillimit ka shërbyer jo vetëm për të mos harxhuar energji të panevojshme, por edhe për të parandaluar fillimin e ndjekjes penale ndaj personave të cilët në fakt nuk dyshohen të kenë kryer ndonjë vepër penale. Në zbatim të detyrimeve të ligjit procedural penal, personave të interesuar u janë dërguar zyrtarisht apo dhe komunikuar vendimet e mosfillimit, për t'u dhënë mundësinë e ushtrimit të së drejtës së ankimit në Gjykatë.

Në uljen e numrit të vendimeve për mosfillimin e procedimit penal ka ndikuar edhe zbatimi më mirë nga shërbimet e policisë gjyqësore pranë komisariateve të policisë të Memorandumit të Mirëkuptimit nr. 1460 prot., datë 30.09.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, dhe udhëzimit të

përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.15, datë 30.10.2020, *“Për trajtimin e njoftimit nga viktimat akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elemente të veprës penale”*.

- **Raportimet sipas Memorandumit të Mirëkuptimit nr. 1460 prot., datë 30.09.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit**

Në vitin 2024 janë regjistruar 1069 raportime mbi marrjen e faktit. Nga këto raportime, janë arkivuar 786 dhe janë shortuar 99 raportime, prej të cilave 39 janë regjistruar si kallëzime penale. Në lidhje me 99 raportimet e regjistruara si kallëzime penale, 36 kallëzime penale janë mosfilluar, 60 kallëzime penale janë regjistruar si procedime penale dhe 3 kallëzime janë në fazë verifikimi të mbartura në vitin 2025. Po ashtu, për vitin 2025 janë mbartur për t'u trajtuar 186 raportime të regjistruara, një numër ky i lartë duke patur parasysh se raportimet bëhen për ato raste kur ngjarja ndiqet drejtpërdrejt me ankim të të dëmtuarit në gjykatë apo dukshëm nuk përmban element të veprës penale. Në këtë drejtim, prokurorët duhet të tregohen me të vëmendshëm për trajtimin brenda një kohe sa më të shkurtër të raportimeve për regjistrim apo arkivim.

- **Afatet hetimore**

Në vitin 2024: janë zgjatur afatet hetimore deri në 3 (tre) muaj për 336 procedime me 409 të pandehur/persona nën hetim; janë zgjatur afatet hetimore nga 3 deri në 6 muaj për 214 procedime me 304 të pandehur/persona nën hetim; janë zgjatur afatet hetimore nga 6 deri në 9 muaj për 137 procedime me 181 të pandehur; janë zgjatur afatet hetimore nga 9 muaj deri në 1 vit për 69 procedime me 91 të pandehur; janë zgjatur afatet hetimore më shumë se 1 vit për 80 procedime me 103 të pandehur.

Megjithëse numri i procedimeve për të cilët është zgjatur afati hetimor është vetëm 18,7% i numrit të përgjithshëm të çështjeve të hetuara gjatë vitit 2024, mbetet një problem numri i çështjeve për të cilat afati hetimor është zgjatur mbi 6 muaj dhe për më shumë se 1 (një) vit.

Në disa raste konstatohet se zgjatja e afateve hetimore nuk justifikohet dhe është irrilevante me shkallën e vështirësisë së hetimit dhe veprimet që nevojitet të kryhen. Për këtë arsye, prokurorët duhet të jenë më të vëmendshëm dhe kujdesshëm në mbikëqyrjen dhe kontrollin dinamik të veprimeve hetimore të oficerëve të policisë gjyqësore, dhënien zgjidhje dhe hartimin e akteve të përfundimit të çështjeve brenda një kohe sa më të shkurtër nga momenti i përfundimit të hetimeve prej oficerëve të policisë gjyqësore, planifikimin e punës sipas prioriteteve dhe shfrytëzimin sa më efektiv të kohës së punës.

- **Masat e sigurimit**

Të dhënat e arrestimeve në flagrancë, ndalimeve me iniciativë nga policia gjyqësore dhe ndalimeve nga prokurori për vitin 2024, janë si më poshtë:

Arrest në flagrancë	Ndalime nga Pol. Gjyqësore	Urdhër ndalimi të Prokurorit	Gjithsej	Urdhër lirimi të menjëhershëm	Kërkesa për vlerësim	Vlerësime të ligjshme	Vlerësime të paligjshme
500	20	5	525	2	523	523	-

Në analizën e treguesve bie në sy fakti që në 2 (dy) raste, nga 525 (pesëqind e njëzetë e pesë) raste gjithësej, arrestimet apo ndalimet janë vlerësuar të paligjshëm nga prokurori dhe është nxjerrë urdhri i lirimit të menjëhershëm.

Raporti i ligjshshmërisë në kërkesat e caktimit të masave sigurimit personal.

	Arrest në burg	Arrest në burg në mungesë	Arrest në shtëpi	Arrest në burg me afat	Garanci pasurore	Detyrim për paraqitje	Masa ndaluese
Kërkuar	261	16	56	2	0	192	24
Vendosur	218	16	71	3	5	210	22

Siç vihet re, numrin më të lartë të masave të sigurimit të kërkuara nga prokuroria dhe të konfirmuara nga gjykata e përbëjnë ato “arrest në burg” dhe “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Gjykata nuk e ka pranuar masën “arrest në burg” në 43 raste të kërkuara prokuroria, ka caktuar masën “arrest në shtëpi” në 15 raste më shumë se sa është kërkuar nga Prokuroria, ka caktuar në 18 raste më shumë nga sa është kërkuar nga Prokuroria masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, si dhe nuk ka caktuar asnjë masë sigurimi në 6 (gjashtë) raste të kërkuara nga prokuroria.

Më poshtë paraqiten masat e sigurimit të kërkuara nga prokuroria dhe të vendosura nga gjykata në raport me vitin 2023:

		Arrest në burg	Arrest në burg në mungesë	Arrest në shtëpi	Arrest në burg me afat	Garanci pasurore	Detyrim për paraqitje	Masa ndaluese
2024	Kërkuar	261	16	56	2	0	192	24
	Vendosur	218	16	71	3	5	210	22
2023	Kërkuar	271	11	42	3	-	152	18
	Vendosur	219	10	54	4	-	185	22

Në vështrim krahasues rezulton se, masat e sigurimit me arrest në burg⁵ në vitin 2024 përbëjnë 50,6% të numrit të përgjithshëm të masave të sigurimit të kërkuara nga prokuroria kundrejt 57,3% që ishin në vitin 2023. Sikurse shihet, në vitin 2024 ka pasur një ulje të kërkesave për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg, por sërish kjo mbetet masa e sigurimit më e kërkuar.

Ndërsa raporti i masave të arrestit në burg të vendosura nga gjykata, konstatohet se në vitin 2024 përbëjnë 44,3% të masave të sigurimit të vendosura nga 47,2% që ishin në vitin 2023.

Apelet ndaj masave të sigurimit

Apel	Gjithsej	Zgjidhja nga Gjykata e Apelit				
		Shfuqizim Vendimi	Nd/Vend. Sipas Apel/Prok.	Nd/Vend M.Sig më të Butë	Mirat. Vend që Pran.K/Pr	Mirat. Vend që Rrëzon.K/P rok.
Nga Prokuroria	2					2
Personi nën hetim	21			19		

Sa i përket kohëzgjatjes së masave të sigurimit, nga të dhënat statistikore, rezulton se për 16 (gjashtëmbëdhjetë) raste prokurori i është drejtuar gjykatës me kërkesë “për zgjatje të afatit të paraburgimit”.

Prokuroria Fier ka treguar përgjithësisht kujdes për të kërkuar masat e sigurimit të përshtatshme, mbi bazën e një analize ligjore të kriterëve dhe kushteve të aplikimit, sipas bindjes së brendshme të prokurorëve. Numrin i lartë i masave të sigurimit arrest me burg lidhet me veprën penale të dhunës në familje, për të cilën masat e tjera të sigurimit përgjithësisht nuk janë proporcionale dhe nuk garantojnë parandalimin e përgjithshëm të veprës apo të autorit të dyshuar.

III. TREGUESIT STATISTIKORË 2-VJEÇAR TË VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL.

Referuar volumit total të punës që ka përballuar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier në krahasim me vitin 2023, rezulton se, gjatë vitit 2024 ka pasur një pakësim të numrit të kallëzimeve dhe procedimeve penale të regjistruara, me 43 (dyzetë e tre) procedime penale më pak. Konkretisht, në vitin 2023 janë regjistruar 2129 (dymijë e njëqind e njëzet e nëntë) procedime penale, ndërsa në vitin 2024 janë regjistruar 2086 (dymijë e tetëdhjetë e gjashtë) procedime penale.

Të dhënat krahasuese mes viteve 2023 dhe 2024 sipas strukturës së Kodit Penal.

⁵ Këtu përfshihen masa e arrestit në burg, arrestit në burg në mungesë dhe arrestit në burg me afat.

100/2					1	1			1	1		
101/1					1	1	1					
102/1							1	1				
102/2							1					
103/1	1						2	1				
103/2							1	2	1	2		
108/1	1	1	1	1	1	1					1	1
108/2							1	1			1	1
108/a-1	1						6	2	2	2	2	2
108/a-2	6	6	7	7	4	4	2	2	2	2	4	4
Totali	10	7	8	8	7	7	17	13	7	8	10	10

Neni	VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT											
109/1							1					
109/b-1	4	4	2	3	2	2	5				2	2
110/1	2	1	1	2								
110/2	3	4	1	3					1	3		
110/a/1-1	1						1					
110/a/2-1	2	1					1	1	1	1		
110/a/3-1	1	4	1	4							1	1
112/2	2						1	3	1	3		
Totali	15	14	5	12	2	2	9	4	3	7	3	3

Neni	VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT											
113/1				1								1
113/2				2								
114/1	3		1	1			2			1	1	1
114/2			1	3	1	3			1	1	1	6
117/1-1	4						2					
117/2-1	2						4	1	1	1		
118	2		1	1	1	1	3				1	1
121/a-1	8	2	4	4	3	3	16	7	5	5	5	5
121/a-2	3	2	1	1	2	2	3	2	3	3	2	2
121/a-3	1	1	1	1	2	2			1	1	1	1
Totali	23	5	9	14	9	11	30	10	11	12	11	17

Neni	VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES											
124/1	2	2	3	3	3	3	1					
124/b-1	5	1	3	3	1	1	12	4	1	2	1	2
124/b-2	1			1			1					
125											1	1
126	1											

159/1	3						2					
161	24	4	3	3	2	2	10	1	2	2	3	3
Totali	142	19	11	12	5	5	117	13	15	16	16	17

Neni	VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE											
170/a-1							5					
Totali							5					

Neni	VEPRA PENALE NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE											
170/c-1							1					
Totali							1					

Neni	KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE											
172/1							1					
174/1	4						1					
174/2										3		
178/1	6	1	2	2			3	1	3	4	3	3
178/2	1											
178/3	1											
179/1	1											
179/2			1	2							1	1
179/a	1						2					
Totali	14	1	3	4			7	1	3	7	4	4

Neni	VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET											
180/1	12	1	12	12	1	1	8	3	7	9	13	13
180/2											1	1
180/3	1						1	1	1	1		
180/a-1							2	1				
180/a-2	1								4	4	2	2
181	3				1	2	1		3	5		
182/a	1		1	1			1				1	1
Totali	18	1	13	13	2	3	13	5	15	19	17	17

Neni	FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË											
183/1	3	1	1	1					1	1	1	1
Totali	3	1	1	1					1	1	1	1

Neni	FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE											
186/1	27	3		2	3	4	13	1	1	1	2	2
186/2	4		2	4	1	1	1	1		3	4	8
186/3	1						1		2	4	2	4
186/a-1	2						3					
187/1	1						2					
187/2							1		1	1	1	1

188/1	2	1	1	2	2	2						
189/1	6	2	2	2	1	1	7					
189/2	3		2	2								
190/1	6	1	1	2	1	1	4	1	2	2	2	2
190/2	1	1			1	2						
191/1											1	1
Totali	53	8	8	14	9	11	32	3	6	11	12	18

Neni	VEPRA PENALE NË FUSHËN E FALIMENTIMIT											
193	1											
Totali	1											

Neni	ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT											
197	26	19	10	14	9	12	58	26	16	17	15	24
198	1	2					1					
Totali	27	21	10	14	9	12	59	26	16	17	15	24

Neni	VEPRA PENALE QË CENOJNË REGJIMIN JURIDIK TË TOKËS DHE TË NDËRTIMEVE											
199	1		1	1	1	1	1		1	1		
199/a-1	70	26	48	51	33	33	86	13	12	12	26	30
199/a-2	2	2	2	2	4	4	1					
199/a-3	5	5	8	10	2	2	1	1	2	2	5	5
199/a-4			2	2	1	1	6	3	4	4	4	4
200	10		3	3			11		1	1	1	1
Totali	88	33	64	69	41	41	106	17	20	20	36	40

Kre. IV	VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT											
201/1	6						4		1	2		
201/a	1											
202/b	3				1	2			1	3	1	2
204			1	1	1	1						
205	6	1	3	4	3	4	1				1	1
206							1		1	1	1	1
206/a-1	2											
206/a-2	1	1										
206/b-1	2	2					3		1	1	1	1
207	1	1										
207/a	3						2					
207/b	1						2					
207/c	1						3					
Totali	27	5	4	5	5	7	16		4	7	4	5

Kre. VIII	KRIME KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT											
-----------	-------------------------------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

128/b/1-1	1											
130/a/1	78	26	45	48	37	39	120	64	57	62	48	53
130/a/2	10	7	8	8	5	5	13	9	13	13	10	10
130/a/3	5	4	6	6	6	7	17	17	12	14	10	14
130/a/4	49	43	40	42	35	36	39	44	51	51	43	45
Totali	152	83	105	111	87	91	203	138	134	142	113	125

Kre.III	VEPRA PENALE KUNDER PASURISË DHE NË SFEREN EKONOMIKE											
Neni	VJEDHJA E PASURISË											
134/1	358	30	35	35	22	22	305	35	44	44	48	48
134/2	20	19	16	23	8	13	26	29	18	32	19	28
134/3	4	7	1	1			5	1			1	1
135	7	2	4	5	2	3	1				2	3
136/1							1					
136/2	1	3									1	2
137/1	7	6	7	8	4	5	10	6	9	9	8	8
137/2	2	2	4	4	2	2			1	1	4	4
138/a-1		2										
138/a-2							1	2	1	2		
139	11	5	2	2			3	1	4	4	3	3
140	3	4					1		2	4		
141			1	2								
141/a-1	11	3	1	1			21	1				
Totali	424	83	71	81	38	45	374	75	79	96	86	97

Neni	MASHTRIMET											
143/1	19	5	8	8	1	1	32	5	5	5	6	6
143/2	4	1	3	4	1	1			2	3	3	6
143/3	2	1	1	1	1	1	5	2	2	3	1	1
143/a/7-1												
143/b-1							2					
144	1											
144/a											1	2
145	1											
146	1						4	2	1	1		
Totali	28	7	12	13	3	3	43	9	10	12	11	15

Neni	SHKATËRRIMI I PRONËS											
150	37	2	2	2	1	1	34	3	2	2	4	4
151	75	13	5	6	2	2	68	9	11	12	9	10
152	2		1	1			2					
155/1							1					
157	1											

Neni	VITI 2023						VITI 2024					
	REGJISTRUAR 2023		DËRGUAR GJYQIT NE 2023		GJYKUAR NE 2023		REGJISTRUAR 2024		DËRGUAR GJYQIT NE 2024		GJYKUAR NE 2024	
	ÇËSHITJE	PERSON NËN HETIM/PANDEHUR	ÇËSHITJE	PANDEHUR	ÇËSHITJE	PANDEHUR	ÇËSHITJE	PERSON NËN HETIM/PANDEHUR	ÇËSHITJE	PANDEHUR	ÇËSHITJE	PANDEHUR

Kre.II	VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT											
--------	------------------------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Neni	KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE											
76-22	5	7		1			5	5	7	8	1	2
76	2						2	1			1	1
78/1	2	2	1	1	3	3	1	2			1	1
78/2					1	4						
78/2									1	2		
79-a			1	1	1	1						
79-b					1	1	1	1				
79-dh	2	2	1	1			1	3			2	2
79/c	1	1	4	4	1	1	3	2	1	1	3	3
84	31	5	5	5	3	3	21	4	2	2	9	9
84/a							1					
Totali	43	17	12	13	10	13	35	18	11	13	17	18

Neni	VEPRAT PENALE TË KRYERA ME DASHJE KUNDËR SHËNDETIT											
88	8	9	8	9	4	4	10	5	6	9	8	11
88/b	1	1										
89	56	23	17	22	18	21	77	27	17	19	14	18
Totali	65	33	25	31	22	25	87	32	23	28	22	29

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI												
91							1					
Totali							1					
Neni	VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZËNISË OSE MOSDHËNIA E NDIHMËS											
96	1		2	6			5				2	3
99	36						19					
Totali	37		2	6			24				2	3

Neni	KRIME SEKSUALE											
100/1	1						2	4	1	1	2	2

Neni	VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA SHTETASIT											
235/1	1				1	1	1	1	1	1		
235/2	1											
236/1	4	4	3	4	1	1	3	3	2	3	2	4
236/2	5	5	2	4	1	4	3	2			2	2
237	4	3	5	5	3	3	5	2	3	3		
238	1						1	1	1	1		
242	14	11	12	12	5	5	17	11	6	6	7	7
242/a			1	1					1	1		
244/1				2			2	2	1	2		2
245/1-1	3						1					
245/1-2							1					
245/1-3									1	2		
247/1	1				1	2	1					
Totali	34	23	23	28	12	16	35	22	16	19	11	15

Neni	VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORE OSE NË SHËRBIM PUBLIK											
248	35	5	6	13	4	7	31	6	4	11	6	18
255	3											
257/a-2							2					
259/1	8	2	1	3			5	1	2	3	1	3
259/2							1					
Totali	46	7	7	16	4	7	39	7	6	14	7	21

Neni	VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE											
272	1						1	1	1	1		
273	16	5	6	6	4	4	9	4	2	3	3	3
274	5	4	4	4	1	1	6	1	2	2	3	3
274/a	1						1					
274/b							1					
275	28	2	2	2	1	1	15	1	1	1		
277	27	17	12	15	5	5	17	2	6	6	9	13
278/1	9	6	6	6	3	3	12	11	6	8	4	6
278/2	4	3					1					
278/3	1	2	1	2	1	1	5	4	4	4	1	2
278/4	1						3	3	3	3	4	4
278/6							1		1	3		
278/7	1	3										
278/a-1	1						1					
279/1	6	3	2	2	2	2	3	2		2	2	3
279/2	26	24	20	23	11	11	5	5	8	8	9	9
280	7	4	5	5	6	6	7	5	4	4	3	3
281/1							1					
282/1	1						1					

282/2							1					
282/a-2									1	1		
283/1	137	56	36	38	36	37	102	54	41	43	40	45
283/2	19	21	10	23	10	24	16	12	12	27	17	29
283/a-1	1						2					
283/a-2									1	3		
283/b	1											
284/1	18	11	15	17	19	19	7	2	5	5	9	10
284/2	6	10	7	15	1	2	1	2	2	6	1	2
284/3	2	1	2	2							1	1
284/d-1	1	1										
285									1	1		
285/a	1	1	1	1							1	1
287	15	2	2	3			15	1	2	3	2	3
287/b	1	1	1	2	1	1		3	1	4	3	4
288/1	1						2					
288/c	1											
289/1	4	1	1	1	1	1	10	3	2	2		
289/2	1		1	2			1	2				
290/1	54	14			2	3	48	6	3	3	1	1
290/2	29	19	19	20	10	10	35	16	18	20	23	26
290/3	22	16	15	15	6	6	21	17	14	14	17	17
290/4			1	1	1	1	2	2			1	1
291	283	273	284	293	167	171	340	312	310	315	316	320
293											1	1
293/b-1	5						2					
293/c-1							1					
293/c-2							1					
Totali	737	500	453	498	288	309	697	471	451	492	471	507

Neni	VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETTIT DHE KUFIJVE SHITETËRORË											
295/a-1	1											
297	36	31	26	26	7	7	8	3	4	4	6	6
298/1	3	1					2					
298/2	1		1	1					1	1	1	1
298/3			1	2	1	1	6	3	2	2	1	1
Totali	41	32	28	29	8	8	16	6	7	7	8	8

Kre:IX	VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË											
300	1	11	1	17		9	1	4	1	3	2	15
301		2		5		1					2	2
302	1	2	1	2			1	2				
305	3	1	5	6	2	3	3		2	2	5	6
305/b		1	2	4	2	5	2	4		2	2	2
309/1	1						1					

312/a							1					
316			1	2	2	3	1	1	2	2	2	2
317	1						1					
318	3	1	1	1			2				1	1
320	5	2	4	4			3	1			2	2
320/a-1	1											
321/1	1						1					
321/2	9	5	8	9	6	6	23	5	5	5	7	7
322	1											
323	13	14	6	7	2	2	26	23	26	27	22	22
324	6	2										
324/a-1	2	2	7	8	1	1	9	4	3	3	5	6
324/a-2	2						1	4	3	6		
Totali	50	43	36	65	15	30	76	48	42	50	50	65


Kre. X	VEPRA PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMOKRATIK TË ZGJEDHJEVE											
325									1	1	1	1
327/a-1	2											
328	1											
329/1	1											
Totali	4								1	1	1	1

N e n i	VITI 2023						VITI 2024					
	REGJISTRUAR 2023		DËRGUAR GJYQIT 2023		GJYKUAR NE 2023		REGJISTRUAR 2024		DËRGUAR GJYQIT 2024		GJYKUAR NE 2024	
	ÇËSHITJE	PERSON NËN HETIM/PANDEHUR	ÇËSHITJE	PANDEHUR	ÇËSHITJE	PANDEHUR	ÇËSHITJE	PERSON NËN HETIM/PANDEHUR	ÇËSHITJE	PANDEHUR	ÇËSHITJE	PANDEHUR
Totali	2082	943	912	1060	576	646	2042	918	881	999	928	1060

Në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, vihet re një ulje e numrit të procedimeve penale të regjistruara. Në lidhje me krimet kundër jetës, vihet re ulje e tyre, ndërsa ka një rritje të veprave penale kundër shëndetit. Gjithashtu, në vitin 2024 janë dërguar më pak çështje në gjyq në raport me vitin 2023, por nga ana tjetër në total ka një numër më të madh çështjesh të përfunduara.

IV. ANALIZA E TREGUESVE TË EFIKTIVITETIT TË PUNËS

Tabela e mëposhtme tregon në përqindje raportin e çështjeve të pezulluara, dërguar për gjykim, pushuar, transferuar në vitin 2024 dhe mbartur në hetim në vitin 2025.



Nga të dhënat statistikore, të pasqyruara edhe në këtë tabelë, konstatohet se numri i procedimeve penale të mbartura është ende shumë i lartë, megjithëse në vitin 2024 numri i procedimeve të përfunduara është më i lartë se ato të mbartura. Vlen të përmendet se numri i çështjeve penale të mbartura është i lartë, pasi për shkak të reformës në drejtësi dhe procesit të rivlerësimit të prokurorëve, procedimet penale mbarten prej disa viteve. Në këtë drejtim kanë ndikuar edhe problematikat dhe kompleksiteti i çështjeve penale, numri i ulët i prokurorëve në raport me strukturën organike, si dhe lëvizjet e shpeshta dinamike të prokurorëve. Në Prokurorinë Fier gjatë vitit 2024 kanë ushtruar funksionin mesatarisht 14 prokurorë. Përgjatë vitit 2024 nuk ka pasur lëvizje të prokurorëve si pasojë e komandimeve, lëvizjeve paralele, shkarkimeve nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit apo dorëheqjes. Dy prej prokurorëve janë larguar me leje barrë-lindje në muajt prill- maj 2024, fakt që ka ndikuar në nivelin e ngarkesës së prokurorëve, numrin e dosjeve të përfunduara, numrin e dosjeve të mbartura në hetim dhe problematika të tjera të dala gjatë këtij viti.


Duhet theksuar gjithashtu se, numri i çështjeve të dërguara për gjykim është më i ulët në raport me numrin e procedimeve penale të pushuara, si pasojë e zbatimit të ligjit nr.33/2024, “Për dhënie amnistie”.

• **GJYKIMI**

	Mbartur në gjykim	Dërguar në gjyq	Të pandehur	Arrest në burg	Përfunduar gjykimi	Të pandehur	Arrest në burg	Gjykim i drejtpërdrejtë	Gjykim i shkurtuar	Gjykim i zakonshëm	Mbarten në gjykim	Të pandehur	Arrest në burg
Viti 2024	1218	881	999	205	928	1060	117	55	40	833	929	1157	336

	Kërkuar nga Prokuroria	Vendosur nga Gjykata
Burgim	411	331
Gjobë	17	34
Pezullim (59,63 K.P)	561	567
Tërheqje akuze	2	0
Pushimi i çështjes	69	72
Pafajësi	0	56

Në formë grafike të dhënat mbi gjykimin paraqiten si më poshtë:



Në vitin 2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka dhënë pafajësi për 31 (tridhjetë e një) procedime penale me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) të pandehur, por në asnjë prej këtyre procedimeve penale të pandehurit nuk ka qenë me masë sigurimi personal “arrest në burg”.

Në krahasim me vitin 2023, numri i të pandehurve për të cilët është dhënë pafajësi është më i madh, konkretisht për 56 të pandehur nga 29 (njëzetë e nëntë) që kanë qenë në vitin 2023.

Pafajësitë sipas veprave penale paraqiten si më poshtë:

Neni	Procedime	Të pandehur
100/1	1	1
124/b-1		1

130/a/1	3	3
130/a/4	2	2
135	1	1
137/1	1	1
143/1	1	1
144/a	1	1
151	1	1
180/1	1	1
190/1	1	1
197	1	7
205	1	1
248	3	10
278/1	1	1
283/1	1	1
283/2	1	2
284/1	1	1
290/3	3	3
291	2	2
300		9
301		1
305	1	1
324/a-1	2	2
325	1	1
Total	31	56

Në lidhje me vendimet e pafajësive për 51 (pesëdhjet e një) të pandehur është ushtruar ankim nga prokurorët e çështjeve, kurse për 5 (pesë) të pandehur nuk është ushtruar ankim. Për katër të pandehur që është dhënë pafajësi dhe nuk është ushtruar ankim, prokurori e ka tërhequr vetë akuzën, kurse për një të pandehur prokurori është pajtuar me vendimin e pafajësisë së gjykatës.

Në lidhje me vendimet e pafajësisë që janë ankimuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nuk ka përfunduar gjykimi. Pas përfundimit të gjykimit në apel të gjitha këto raste do t'u nënshtrohen analizave për të vlerësuar përgjegjësitë e prokurorit.

Ky tregues, pavarësisht pretendimeve për bazueshmërinë e vendimeve të gjykatës, duhet të merret në konsideratë për të bërë kujdes në sigurimin e provave në hetimin paraprak, por edhe për rritjen e rolit të prokurorit gjatë shqyrtimit gjyqësor, sidomos në fazën e administrimit të provave.

Në fazën e gjykimit i është kushtuar rëndësi sigurimit të provave të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurve, si dhe diferencimit të llojit dhe masës së dënimit në varësi të veprës penale të kryer, rrethnave, mënyrës e motiveve të kryerjes së veprës penale, si dhe personalitet të të pandehurit.

Për veprat penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si ato kundër jetës dhe shëndetit, vjedhjet, mashtrimet, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, veprat penale

në fushën e narkotikëve, etj, kërkesat e Prokurorisë për llojin dhe masën e dënimit kanë qenë proporcionale në funksion të dënimit dhe parandalimit të këtyre veprave penale.

Megjithatë, duke analizuar gjithë treguesit e këtij viti mendojmë se është e nevojshme që politika e dënimit të përmirësohet në vijimësi, duke e bërë më fleksibël dhe përshtatur me format dhe tendencat e kriminalitetit në rrethin tonë.

➤ **Të dhënat për të miturit në konflikt me ligjin, viktimat/dëshmitarë të veprave penale.**

◦ **Të miturit në konflikt me ligjin**

Në vitin 2024 janë referuar/njoftuar 109 (njëqind e nëntë) materiale me të mitur në konflikt me ligjin, prej të cilat janë regjistruar 84 (tetëdhjetë e katër) procedime penale. Nga procedimet penale, 48 (dyzetë e tetë) rezultojnë me të mitur në konflikt me ligjin, kurse 36 (tridhjetë e gjashtë) janë regjistruar pa emër personi në hetim. Gjithashtu, janë mosfilluar 4 (katër) materiale të referuara me të mitur në konflikt me ligjin dhe rezultojnë 15 (pesëmbëdhjetë) kallëzime penale në fazë verifikimi.

Dyzetë e tetë procedime penale me të mitur në konflikt me ligjin janë me 74 (shtatëdhjetë e katër) emra autorësh të regjistruar, nga të cilët 70 (shtatëdhjetë) meshkuj dhe 4 (katër) femra, të gjithë shtetas shqiptarë. Gjithashtu, 6 (gjashtë) prej të miturve në konflikt me ligjin janë të grupmoshës 14-16 vjeç dhe 68 (gjashtëdhjetë e tetë) i përkasin grupmoshës 16-18 vjeç. Nga autorët e mitur në konflikt me ligjin 5 (pesë) persona rezultojnë përsëritës.

Gjashtë prej të miturve në konflikt me ligjin janë hetuar me masë sigurimi personal: 3 (tre) me masë sigurimi “vendosje nën mbikëqyrje”, 1 (një) me “arrest në shtëpi” dhe 2 (dy) me “arrest në burg”.

Masa e shmangies nga dënimi për të miturin në konflikt me ligjin është zbatuar në 40 (dyzetë) raste, nga të cilat:

- për 33 të mitur është aplikuar masa “*këshillim me të miturin dhe familjen*”, bazuar në nenin 65, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;
- për 4 të mitur është aplikuar masa “*paralajmërim me gojë*”;
- për 3 të mitur është aplikuar masa “*paralajmërim me shkrim*”.

Gjithashtu, rezulton se janë pushuar për shkak tjetër 3 (tre) procedime penale dhe është pezulluar 1 (një) procedim penal.

Në vitin 2024 janë dërguar në gjykim 20 (njëzetë) procedime penale me 22 (njëzetë e dy) të mitur në konflikt me ligjin, nga të cilat janë pranuar deri aktualisht gjashtë kërkesa prej Gjykatës së Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Nga prokurori është kërkuar “dënimi alternativ” për 5 (pesë) të mitur, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata, ndërsa për 1 (një) të mitur është dhënë pafajësi. Në fund të vitit 2024 janë ende në hetim 43 procedime penale me të mitur në konflikt me ligjin.

◦ **Të miturit viktimë**

Numri i çështjeve me të mitur viktime ka qenë 49 (dyzetë e nëntë), me 61 (gjashtëdhjetë e një) të mitur viktime, prej të cilëve 42 (dyzetë e dy) janë të gjinisë femërore dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) janë të gjinisë mashkullore. Nga 49 (dyzetë e nëntë) procedime penale me të mitur viktime të veprave penale, janë mbartur në hetim 34 (tridhjetë e katër) procedime penale, mosfilluar 5 (pesë) kallëzime penale, kurse 10 (dhjetë) procedime penale janë dërguar për gjykim.

Koordinatori për viktimat ka asistuar gjatë pyetjes në procesin penal të viktimave të veprave penale në 176 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) raste, për të cilat është kujdesur të respektoheshin të drejtat në procesin penal, si dhe ka bërë referimin e rasteve në institucionet përkatëse sipas nevojave të rasteve konkrete.

Mbi bazën e urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe drejtuesit të Prokurorisë Fier vazhdon të administrohet regjistri manual dhe elektronik.

V. EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE DHE MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA

◦ Ekzekutimi i vendimeve penale

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka përbushur edhe detyrimet procedurale në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale.

Rezultatet e vitit 2024 në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale janë:

Vendime	Dënim me burg		Dënim me gjobë		Dënime plotësuese		Neni 59 K.P.		Neni 63 K.P.		Masa mjekësore	Shpenzime procedurale+ të tiera
	Urdhra	Ekzekutuar	Urdhra	Ekzekutuar	Urdhra	Ekzekutuar	Urdhra	Ekzekutuar	Urdhra	Ekzekutuar		
956	247	21	20	2	60	37	455	100	52	21	60	395

Sikurse përmendet edhe më lart, në vitin 2024 u miratua dhe hyri në fuqi ligji nr.33/2024, datë 04.04.2024, “Për dhënie amnistie”, sipas të cilit u përjashtuan nga vuajtja e dënimit personat që plotësonin kriteret e përcaktuara në nenin 3, të këtij ligji.

Nga zbatimi i ligjit nr. 33/2024, “Për dhënie amnistinë”, kanë përfituar 91 të dënuar, për veprat penale, si më poshtë:

Nr.	Neni	Të dënuar
1.	108/a/2	1
2.	124/b	1

3.	130/a	2
4.	134	3
5.	180/1	2
6.	186/1	2
7.	189/1	1
8.	197/1	2
9.	199/a	10
10.	200	1
11.	235/1	1
12.	236	1
13.	237/3	1
14.	259/2	2
15.	279/2	2
16.	280	1
17.	283	2
18.	290	2
19.	291	53
20.	297	1
21.	298/3	1
22.	324/a	1

◦ **Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja**

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier janë trajtuar dhe ndjekur kërkesat në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja si më poshtë:

Veprat Penale të Grupuara sipas Krerëve	Ekstradimi për Jashtë Shtetit	Ekstradimi nga Jashtë Shtetit	Letërporosi nga Jashtë	Letërporosi për Jashtë	Njohje Vend Penale Huaja
	Kërkesa për ekstradim	Kërkesa për ekstradim	Kërkesa e Prokurorit	Kërkesa e Prokurorit	Kërkesa e Prokurorit
Kr.II - V.P K/Personit		2	3	2	
Kr.III - V.P K/Pasurise dhe Ekonomi	1	3	9	3	
Kr.VIII - V.P K/Autorit.Shtetit	3	6	25	3	2
TOTALI	4	11	37	8	2

Gjithashtu, janë lëshuar 34 (tridhjetë e katër) urdhra për kërkim ndërkombëtar.

VI. TË DHËNAT PËR NGARKESËN DHE TREGUESIT E PUNËS PËR PROKURORËT

o Ngarkesa e prokurorëve

PROKURORI	MBARTUR NE 24 (+KTHYER NGA GJYKATA NGA	REGJISTRUAR 2024	RIFILLLUAR/SHF UQIZUAR	TOTALI NË HETIM	BASHKUAR	PEZULLUAR	PUSHUAR	TRANSFERUAR	DERGUAR NË GJYQ	GJITHSEI PËRFUNDUAR	MBETUR NË HETIM	MOSFILIME
ELION MUSTAJ	39			39	1	3	13		5	22	17	
ELIDA HOXHAJ ⁶	161	214	3	378	7	45	113	3	100	268	110	39
PETRIT VUKAJ ⁷	135	157	1	293	2	22	62	1	107	194	99	17
AIDA CAKAJ ⁸	266	39	1	306	6	31	89	3	47	176	130	14
BLERINA MUSABELLIU ⁹	155	177	2	334	4	47	75	1	27	154	180	31
DENIS HYKA ¹⁰	296	256	1	553	8	79	149	6	117	359	194	45
ELONA GIXHARI	201	209		409	5	29	75	1	76	186	223	36
ERVIS ALLIAJ	263	218	1	482	2	65	126		125	318	164	30
GENCI MANE	244	166		410	6	1	87		50	144	266	9
GRETA DRENI		134	2	136	2	23	7		33	65	71	29
JONIDA ALLUSHI	220	72		292	5	28	51	2	45	131	161	20
KRISTI JORGJI	1	122		122		23	8		18	49	73	29
LEONARD SUÇI	183	72		255	2		43	5	30	80	175	8
LORENA SALILLARI ¹¹	8	6		14		2			12	14	0	
OLIANA GJERGJEFI	224	204	3	431	9	37	95		64	205	226	34
REDONA NDONI ¹²	22	31		53	1	2	25	2	21	51	2	23
AIDA CAKAJ + ELION MUSTAJ	1	1		2					1	1	1	
DENIS HYKA+ ELION MUSTAJ	1	1		2				1		1	1	
DENIS HYKA+ PETRIT VUKAJ		1		1					1	1	0	
ERVIS ALLIAJ + ELION MUSTAJ + ELONA GIXHARI	1			1					1	1	0	

⁶ Drejtuese e seksionit të përgjithshëm për veprat e tjera penale.

⁷ Drejtues i seksionit për të mitur, ekzekutimit të vendimeve penale dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë.

⁸ Drejtuese e seksionit të posaçëm.

⁹ Seksioni i përgjithshëm, transferuar me caktim të përkohshëm në Prokurorinë Fier që në muajin qershor të vitit 2024.

¹⁰ Ngarkesa që ka prokurori Denis Hyka është më e madhe se e prokurorëve të tjerë për shkak se është i vetmi prokuror që ka qenë gjatë gjithë vitit 2024 në të njëjtin seksion, atë të përgjithshëm, kurse prokurorët e tjerë të këtij seksioni janë larguar për një pjesë të vitit, për arsye të ndryshme objektive.

¹¹ Seksioni i përgjithshëm, larguar me leje barrëldje në 22 prill 2024.

¹² Seksioni i përgjithshëm, larguar me leje barrëldje në 23 maj 2024.

ELION MUSTAFAJ + ELONA GIXHARI + LORENA SALLARI		1		1				1		1	0	
PETRIT VUKAJ + OLIANA GJERGJEFI		1		1			1			1	0	
ERVIS ALLIAJ + ELION MUSTAFAJ	1	1		2					1	1	1	
ELION MUSTAFAJ + ELONA GIXHARI		1		1						0	1	
ERVIS ALLIAJ + ELONA GIXHARI		1		1						0	1	
LEONARD SUÇI + JONIDA ALLUSHI	2	1		3						0	3	
OLIANA GJERGJEFI + LEONARD SUÇI	1											
JONIDA ALLUSHI + ELION MUSTAFAJ	1											
GENCI MANE + AIDA CAKAJ	1											
GENCI MANE +JONIDA ALLUSHI	1											
TOTALI	2428	2086	14	4528	60	437	1019	26	881	2423	2105	364

Të dhënat mbi ngarkesën e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit, janë si më poshtë:

OPGJ	HETUAR	PËRFUNDUAR	URDHRA EKZEKUTIMI
Alfred Stojku	869 ¹³	863	9
Alket Lala	115	78	
Ameli Kararaj	133	113	571
Arbër Braho	94	58	
Artur Boni	65	33	
Brixhilda Sinjari	66	43	331
Dritan Ibro	91	46	
Dorjan Hoxha	262	197	
Durim Fejzulla	110	68	
Endri Breshani	130	105	
Erjon Shabani	90	65	450
Fotion Malaj	60	41	--
Klodian Buzi	238	211	
Marsel Shahu	120	119	192

¹³ Në pjesën më të konsiderueshme janë procedime penale të rifilluara për shkak të plotësimit të afatit të parashkrimit të ndjekjes penale.

VII. ZBATIMI I BUXHETIT

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike-financiare janë çelur fondet si më poshtë:

Në mijë/lekë

Fondi 2024	Plan	Fakt	Realizimi %
Fondi i Pagave 600	175 600	175 223.51	99.79%
Fondi i Sigurimeve Shoq. e Shëndet.	18 610	17 997	96.7%
Fondi i shpenzimeve korrente	21 570	21 563	99.97%
Fondi transferta korrente të brendshme	190.34	190.34	100%
Fondi i investimeve	1 816.87	1 608.26	88.52%

Fondi i pagave ka një diferencë prej 376.49/mijë lekë ose është realizuar në masën 99.79%. Gjatë vitit 2024, është kryer pagesa e magjistratëve për detyrimet e prapambetura të pagës për vitin 2021 (Qershor–Dhjetor) dhe vitin 2022 (Janar–Dhjetor), në vlerën 20 725/mijë lekë.

Totali i pagesës së orëve të gadishmërisë për prokurorët është në shumën 7770.55/mijë lekë dhe totali i pagesës së mbikohës së punës për prokurorët është 299.2 mijë lekë, sipas Vendimit nr. 191, datë 13.05.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i ndryshuar.

Llogaritja e fondit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është bërë sipas ligjeve në fuqi, sigurimi shoqëror në masën 9.5% mbi pagën maksimale në Republikën e Shqipërisë, e cila është 176 416 lekë, kurse sigurimi shëndetësor dhe kontributi suplementar janë llogaritur mbi pagën bruto.

Lidhur me realizimin e fondit të shpenzimeve korrente realizimi është 99.97%, si më poshtë:

- materiale zyre dhe të përgjithshme në shumën 593.6 mijë lekë, ku përfshihen shpenzimet për kancelari, materiale pastrimi, dizifektimi, materiale të përgjithshme për funksionimin e zyrave, ku peshën më të madhe e zenë shpenzimet për kancelari në masën 57.6% të totalit, materiale shtypshkrime janë në masën 25.3%;
- shërbime nga të tretë në shumën 8421/mijë lekë, ku përfshihen shpenzimet për energji elektrike, ujë, shërbime telefonike, shërbime postare, shërbim roje godine, etj. Peshën më të madhe e zenë shpenzimet për “Shërbime për ruajtje godine” në masën 74.8% të totalit;
- shpenzime transporti janë në shumën 133/mijë lekë, ku përfshihen shpenzimet për pjesë këmbimi, goma dhe bateri, shpenzime për siguracionet e makinave dhe shpenzime të tjera transporti. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Fier ka në pronësi 3 (tre) automjete: automjetet “HYUNDAI” me targa AA082EK dhe AA901MP, “Skoda” me targë AA347PF.
- shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme janë në shumën 564.8 mijë lekë, ku përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit. Peshën më të madhe të shpenzimeve të këtij grupi e zenë shpenzimet për riparimin e pajisjeve elektronike, si fotokopje, printera, për ti

mbajtur në gadishmëri për një funksionim sa më normal të punës në sekretari. Këto shpenzime zenë shumën 502.3 mijë lekë ose 89% të fondit total të grupit.

Shpenzime të tjera operative janë në shumën 11805.29 mijë lekë, ku përfshihen shpenzimet për honorare që janë pagesat e avokatëve, ekspertëve, përkthyesve etj, janë 7513/mijë lekë ose 64%, me peshën me të madhe të fondit total të grupit.

Në fund të vitit gjendja me fatura të palikuiduara për këtë zë është vetëm fatura të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Jug, në shumën 4000 lekë, e bërë hyrje në Prokurori në datën 31.12.2024.

Realizimi i fondeve është në masën 99.54%. “Shpenzime për rritjen e “AQT” janë në shumën 1608.26 mijë lekë, në masën 88.52%. Fondi i shpenzimeve për rritjen e AQT-ve ka të bëjë me:

- *blerje pajisje për sistemin e sigurisë në vlerë 579.18 mijë lekë;*
- *blerje pajisje për mbrojtjen ndaj zjarrit në vlerë 408 mijë lekë;*
- *blerje orendi zyre në vlerë 212/mijë lekë;*
- *blerje dhe instalim kondicionerë në vlerë 304.68 mijë lekë;*
- *blerje pajisje zyre në vlerë 104/mijë lekë.*

Nga ana tjetër, rezulton se janë krijuar të ardhura, të cilat janë derdhur në buxhetin e shtetit:

- 18 mijë lekë nga tarifat e taksave të pullave ;
- 1.5 mijë lekë nga shpenzimet procedurale;
- 196.31 mijë lekë nga fotopjet e akteve procedural.

Gjatë vitit 2024, buxheti financiar i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është administruar me rigorozitet dhe si pasojë e disiplinës financiare dhe ndihmës gjithëvjetoje nga Prokuroria e Përgjithshme për zëra të veçantë të tij, nga ana e kësaj Prokurorie janë likuiduar pothuajse të gjitha detyrimet ndaj subjekteve të tjerë, ato për shpenzimet procedurale, të pagesës së mbikohës së punës, etj. Megjithatë, vlerësoj se ky buxhet duhet të rishikohet në të ardhmen për shtimin e tij në zëra të veçantë për një mbarëvajtje më të mirë të punës, duke u nisur nga fakti që nga viti në vit shtohet ngarkesa e punës dhe për rrjedhojë dhe nevojat financiare.

VIII. VEPRIMTARIA DHE SHËRBIMET ADMINISTRATIVE

Nga personeli administrativ i kësaj prokurorie janë kryer përgjithësisht me korrektesë detyrat përkatëse, duke qenë një mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në përballimin e ngarkesës në punë, por edhe në krijimin e raporteve me qytetarët, të cilëve u ofrohen shërbime administrative.

Në bazë të strukturës organike, Prokuroria Fier ka të miratuar në përbërje të saj 24 (njëzetë e katër) prokurorë, 18 (tetëmbëdhjetë) oficerë të policisë gjyqësore, 1 (një) kancelar, 1 (një) kryesekretare, dhe nëpunës të tjerë të sekretarisë dhe shërbimeve mbështetëse.

Prokuroria Fier ka patur një volum të madh pune me një numër të lartë të kallëzimeve penale, referimeve pasurore, procedime penale në hetim dhe në gjykim, praktika të ekzekutimit të vendimeve penale dhe çështje të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, etj. Krahas kësaj ngarkese, në muajt e fundit të vitit 2024 ka fillur procesi i

transferimit të një pjese të arkivës së prokurorisë në godinën e ish-Prokurorisë Kavajë, proces ky që ka nevojë për vëmendje dhe kujdes për garantimin e transportimit, kushteve dhe ambienteve, përpunimin e dokumenteve arkivore, etj.

Në vitin 2024 janë bërë përpjekje të vazhdueshme për sigurimin e ambienteve të përshtatshme të punës së prokurorisë, dhe është hartuar një projekt-ide për shtesën e një ndërtimi në katin e 4 (katër) me 6 zyra. Në këto kushte, vlerësohet se emërimi i kancelarit është i domosdoshëm për zhvillimin e procedurës së prokurimit publik apo realizimin e punimeve për shtesën e godinës.

Mungesa e kancelarit ka ndikuar dhe ndikon në mbarëvajtjen e punës administrative, si një hallkë e domosdoshme në mbështetje të punës së prokurorëve dhe mirëfunksionimin e prokurorisë. Kjo ka sjellë angazhimin e drejtuesit të prokurorisë në kryerjen e detyrave administrative të kancelarit, duke u bërë kështu pengesë për ushtrimin prej tij të kompetencave në ushtrimin më me efikasitet të ndjekjes penale.

Lidhur me administrimin e dokumentacionit të Prokurorisë, konstatohet se regjistrat dhe dokumentacioni që administrohet në Prokurori, përgjithësisht mbahet dhe ruhet rregullisht. Lidhur me mbajtjen e regjistrave, në Prokurori ushtrojnë veprimtarinë punonjësit e ngarkuar posaçërisht me detyrën e mbajtjes së tyre, si dhe një prokuror përgjegjës për mbikqyrjen. Vlerësohet se duhet kujdes i shtuar në rakordimin e të dhënave të prokurorëve me zyrën e regjistratit përmes depozitimit në kohë prej prokurorëve të akteve që duhet të regjistrohen, hedhjen/plotësimin e të dhënave në sistemin elektronik, regjistrimin e akteve të përgjimit për të cilët prokurorët duhet të përmbushin me përgjegjësi detyrimet e tyre ligjore, etj. Nga drejtuesi i Prokurorisë është ndërhyrë duke marrë masa lidhur me mënyrën e administrimit të materialeve hetimore ku janë hartuar formularë përkatës. Po ashtu, është ngritur grup pune për kontrollin e rregullshmërisë së regjistrave dhe informimin mbi problematikat, etj.

Në lidhje me shpërndarjen e çështjeve është proceduar me shortin elektronik sipas seksioneve nëpërmjet sistemit CAMS. Kjo formë shortimi nuk është përdorur për rishpërndarjen e çështjeve të dorëzuara prej prokurorëve të larguar, çështjeve të kthyer nga Gjykata për vazhdimin e hetimeve që i kanë patur prokurorët e larguar, si dhe për procedimet penale të ardhura për kompetencë, sepse sistemi CAMS nuk realizon shpërndarje të drejtë mes prokurorëve, në rastet kur rishortohen disa procedime penale. Për këto raste është proceduar me shortim manual, duke u mbajtur edhe procesverbali përkatës i shortit, sipas rregullave. Po ashtu, janë përjashtuar nga shortimi në përputhje me Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3, datë 29.12.2016, *“Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori”*, materialet e referuara për hetim apo kallëzimet penale që kërkonin veprime të menjëherëshme.

Në lidhje me kapacitetet infrastrukturore, drejtuesi i Prokurorisë ka pasur në vëmendje të veprimtarisë së përditshme mbështetjen e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve të tyre, duke vënë në shërbim të tyre burimet njerëzore të duhura dhe logjistikën e disponueshme në Prokurori. Pas zbatimit të hartës së re gjyqësore janë konstatuar problematika lidhur me ambientet dhe hasen vështirësi për administrimin e arkivës në një vend për shkak të mungesës së ambienteve, ndaj një pjesë e arkivës është ende në godinën e ish-Prokurorisë Lushnje, çka vështirëson procesin e marrjes së akteve nëse kërkohen nga prokurorët të këqyren, verifikimin dhe dorëzimin e kopjeve të akteve palëve kërkuese.

Në lidhje me nevojat e dala rezulton se praktika aktuale e vendosjes së Prokurorisë në të njëjtën godinë me Gjykatën ka dhënë rezultate shumë të mira si në drejtim të rritjes së kohës efektive të prokurorëve për të vijuar ushtrimin e funksioneve pas përfundimit të gjykimeve, por edhe ushtrimit të mbikëqyrjes së oficerëve. Ndër të tjera kjo praktikë siguron administrimin e sigurtë të dosjeve nga prokuroria në gjykatë, garanton sigurinë në lëvizjen e provave materiale që bashkohen me fashikullin e gjykimit, por edhe të ekzekutimit të urdhrave të ekzekutimit, në lidhje me kthimin e provave materiale. Për rrjedhojë rekomandohet që në të ardhmen të vijojë të ndiqet kjo praktikë dhe jo vetëm, por edhe mund të përsoset më tej duke krijuar një godinë të vetme për gjykatën, prokurorinë, policinë gjyqësore dhe zyra për mjekun-ligjor dhe atashimin pranë Prokurorisë të ekspertëve vlerësues të dëmit apo autoteknik.

Nga ana tjetër, shtimi i kërkesave për informacion dhe të dhënave statistikore nga KLP-ja, ILD-ja, Prokuroria e Përgjithshme, shtron nevojën e shtimit të organikës me staf administrativ, duke shtuar numrin e stafit administrativ apo krijuar pozicione të reja.

Për sa i përket sigurisë së godinës, kjo realizohet nëpërmjet shërbimeve private të ruajtjes fizike, për të cilat çdo vit organizohet procedura përkatëse në përputhje me ligjin. Nuk rezulton të ketë pasur problematika lidhur me sigurinë, megjithatë, mund të vlerësohet se nisur nga natyra e veprimtarisë së Prokurorisë, vlerësoj se do të ishte e përshtatshme që siguria të garantohej nga shërbimet e policisë të Drejtorisë së Policisë.

Në vitin 2024, vlerësoj se përgjithësisht është respektuar disiplina në punë dhe kodi i etikës nga prokurorët, oficerët dhe punonjësit e administratës. Megjithatë, në drejtim në shfytëzimit efektiv të kohës së punës dhe disiplinës në punë ka nevojë për përmirësim dhe ndërgjegjësim më të lartë, qoftë në aspektin e përmbajtjes, ashtu edhe të formës.

- Në funksion të respektimit të disiplinës dhe etikës në punë, nga ana e drejtuesit të prokurorisë është nxjerrë urdhri nr. 43, datë 18.10.2023, *“Për disiplinimin dhe mbikëqyrjen e disiplinës në punë të Oficerëve të Policisë Gjyqësore të Seksionit të Prokurorisë”*, dhe Urdhri nr. 58, datë 19.12.2023, *“Për ngritjen e komisionit të monitorimit/kontrollit të rregullit dhe sigurisë në Prokurorinë Fier”* dhe Urdhri nr. 80, datë 23.09.2024, *“Për disiplinimin e hyrje-daljeve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, si dhe miratimin e procedurës së hartimit të listëprezencës në punë”*.

IX. MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN DHE MEDIAN

Marrëdhëniet me median dhe publikun kanë qenë korrekte, me rritje të rolit të prokurorit të medias dhe koordinatorit të marrëdhënieve me publikun, jo vetëm përmes marrjes së masave për përditësimin e faqes së internetit, kthimit të përgjigjeve subjekteve që drejtohen mbi bazën e ligjit për të drejtën e informimit, por edhe monitorimin dhe vlerësimin e informacioneve mediatike dhe burimeve të tjera të hapura me qëllim rritjen e hetimeve kryesisht.

Në funksion të këtij qëllimi është nxjerrë edhe urdhri i drejtuesit të prokurorisë nr. 59 datë 19.12.2023, i cili ka qenë në fuqi gjatë vitit 2024, sipas të cilit janë ngarkuar dy oficerë për të verifikuar publikimet që vijnë nga media dhe burimet e tjera të hapura, dhe me monitorimin e zbatimit të tij janë ngarkuar drejtuesit e seksioneve dhe prokurori i

medias e marrëdhënieve me publikun. Në vitin 2024 janë referuar për fillim procedimi penal 8 (tetë) raste, shumica e të cilave kanë qenë për veprat penale që lidhen me shpërdorimin e detyrës nga funksionarët publikë.

Nga ana e Prokurorisë është shprehur gatishmëria për të dhënë informacion subjekteve të interesuar në çdo rast, që është gjykuar se nuk cenohen hetimi dhe veprimet procedurale përkatëse. Në respektim edhe të parashikimeve kushtetuese është respektuar e drejta për informim e subjekteve të ndryshme. Në rast të refuzimit të kërkesave për informacione lidhur me çështje konkrete, ato janë argumentuar bazuar në normat procedurale penale mbi ruajtjen e sekretit hetimor.

Prokurori dhe koordinatori për marrëdhëniet me publikun janë kujdesur në përputhje me ligjin nr. 119/2014, *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar, për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e Prokurorisë, si dhe për çështje të veçanta, duke zbatuar kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjen e hetimit.

Për sa u përket çështjeve penale sensitive dhe me interes publik janë përgatitur dhe publikuar njoftime për shtyp në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, duke bashkëpunuar efektivisht me këshilltarin e mediave të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Gjatë vitit 2024 janë publikuar gjithsej 40 njoftime për shtyp për çështje të cilat janë vlerësuar se kanë interes publik dhe mediatik, një numër pothuajse sa dyfishi i vitit të kaluar.

Gjithashtu, janë trajtuar 26 kërkesa për informacion ku është patur në vëmendje t’u kthehet përgjigje e plotë, e qartë dhe duke respektuar afatet bazuar në ligjin nr. 119/2014. Në asnjë rast nuk është marrë masë për moskthimin e përgjigjeve në kohë nga Komisioneri për të Drejtën për Informim.

Një kujdes i veçantë i është kushtuar ruajtjes së të dhënave personale në informacionet e publikuara, si dhe kërkesave të trajtuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, bazuar në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*.

Përmes faqes së internetit të Prokurorisë në funksion të forcimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut janë publikuar të dhëna orientuese lidhur me të drejtën e ankimit ndaj vendimmarrjeve të prokurorit, të drejtat për marrjen e kopjeve të akteve etj.

Një kujdes i veçantë i është kushtuar ruajtjes së një raporti besimi dhe transparence me publikun dhe median. Për këtë shkak, në mbledhjet e organizuara me prokurorët dhe administratën e Prokurorisë është bërë prezent gjithmonë kërkesa për informim dhe kthim përgjigje sipas ligjit si për publikun dhe median, pa cenuar pavarësinë e prokurorit dhe sekretin hetimor. Në këtë drejtim, qasja ka qenë pozitive dhe bashkëpunuese.

Ndërsa lidhur me kërkesat për informacion të bëra në bazë të Kodit të Procedurës Penale lidhur me çështjet në hetim, rezultojnë të jenë bërë 242 të tilla nga shtetasit dhe 249 nga avokatët. Konstatohet se, për çështje penale konkrete nga prokurorë të veçantë është treguar neglizhencë në kthimin e përgjigjeve për subjektet procedurale sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Penale, fakt për të cilën ato janë vënë në dijeni nga drejtuesi dhe tërhequr vëmendje për kujdes. Në këtë drejtim, prokurorët duhet të tregojnë më shumë kujdes për trajtimin dhe kthimin përgjigje të kërkesave/ankesave/memo proceduriale brënda afatit ligjor. Mungesa e trahtimit dhe kthimit të përgjigjeve brenda afateve ligjore do cenonte besimin e publikut tek organi i prokurorisë.

X. OBJEKTIVAT SIPAS DREJTIMEVE PRIORITARE NË VEPRIMTARINË ADMINISTRATIVE DHE FUNKSIONALE TË PROKURORISË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIME.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka patur një ngarkesë të konsiderueshme, të shkaktuar, ndër të tjera, edhe nga mungesa e prokurorëve. Megjithatë, prioritetet tona kryesore ngelen:

➤ Hetimi me përparësi i krimeve e rënda, veprave penale kundër jetës, shëndetit, kundër rendit dhe sigurisë publike, kundër pasurisë, veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale, veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, abuzimit me detyrën të nëpunësve shtetërorë, krimet seksuale, veçanërisht ndaj të miturit, trafiqet e paligjshme, krimet në fushën e mjedisit, krimet në familje, krimet kundër mjedisit, krimet kompjuterike, krimet kundër narkotikëve dhe çdo lloj forme tjetër krimi që konsiderohet shqetësuese për komunitetin ku ushtrojmë detyrën.

➤ Shtimi i kërkesave për vendosjen e masave ndaj pasurisë me burim kriminal, në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe ligjit nr. 10192/2009, i ndryshuar.

➤ Shtimi i përpjekjeve nga prokurorët për të bërë të mundur rritjen e koeficientit të zbulueshmërisë së veprave penale, përdorimi i metodave speciale të hetimit, bashkëpunimi me policinë gjyqësore dhe me gjithë aktorët e përfshirë në një procedim penal.

➤ Garantimi i respektimit të të drejtave dhe garancive procedurale të subjekteve të përfshirë në një çështje penale, si dhe me fokus mbrojtjen e të drejtave të viktimës së veprës penale.

➤ Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit në hetimet paraprake të kryera nga policia gjyqësore, kjo edhe nëpërmjet ndërgjegjësimit të policisë gjyqësore për rolin dhe veprimet e tyre në një procedim penal.

➤ Rritja e profesionalizmit të prokurorëve dhe ruajtja e një figure morale të pastër jashtë çdo ndikimi, në funksion të rritjes së besimit të publikut në ofrimin e drejtësisë.

➤ Rritjen e numrit të kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë dhe për zbatimin e instituteve procedurale penale të posaçme, si gjykimi me marrëveshje dhe urdhri penal, duke vlerësuar kushtet dhe kriteret ligjore dhe synimet prioritare.

➤ Rritja e numrit të procedimeve penale të regjistruara kryesisht, me iniciativë të prokurorëve.

➤ Krijimi i infrastrukturës së nevojshme dhe ambienteve, si dhe pajisjeve të nevojshme për të ushtruar detyrën.

➤ Koordinimi me Prokurorinë e Përgjithshme, Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe institucionet e tjera për të bërë të mundur një godinë të përbashkët me Gjykatën për ushtrimin e veprimtarisë së Prokurorisë Fier sipas standarteve më të mira.

➤ Rritjen e bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë, Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksionit

të Përgjithshëm Fier, Drejtorinë Vendore të Policisë Fier dhe organet e varësisë, si dhe insitucionet e tjera ligjzbatuese në nivel qendror dhe lokal për mirëfunksionimin e Prokurorisë dhe ushtrimin me efikasitet të ndjekjes penale, në përputhje me ligjet dhe aktetve nënligjore.

➤ Krijimi i një mjedisi bashkëpunues dhe të sigurtë për ushtrimin e funksioneve prej prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe nënounësve të administratës së prokurorisë.

DREJTUESI I PROKURORISË

ELION MUSTAFAJ

